



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 2 qershor 2023
Nr. ref.:RK2200/23

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI13/22

Parashtrues

"Flori Print" SH.P.K.

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit ARJ-UZVP. nr. 82/2021,
të Gjykatës Supreme të Kosovës, i 26 gushtit 2021**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe
Enver Peci, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga "Flori Print" SH.P.K. me seli në Drenas, i përfaqësuar nga Kushtrim Bytyqi, avokat nga Prishtina (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [ARJ-UZVP. nr. 82/2021] të 26 gushtit 2021, të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), në lidhje me Aktgjykimin [AA. nr. 381/2021] të 28 majit 2021, të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Departamenti për Çështje Administrative (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) dhe Aktgjykimin [A. nr. 2574/19] të 3 shkurtit 2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti Administrativ, Divizioni Fiskal (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).
3. Parashtruesi i kërkesës Aktgjykimin e kontestuar e ka pranuar më 4 tetor 2021.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, përmes të cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNj).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa Individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 27 janar 2022, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 3 shkurt 2022, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimit [nr. GJR. KI13/22] dhe Vendimit [nr. KSH. KI13/22], caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërzhaliu-Krasniqi (kryesuese), Radomir Laban dhe Remzije Istrefi-Peci (anëtarë).
8. Më 3 shkurt 2022, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje të kërkesës ia dërgoi Gjykatës Supreme.
9. Më 3 shkurt 2022, Gjykata e njoftoi Gjykatën Themelore për regjistrimin e kërkesës, duke kërkuar nga ajo që në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të shkresës, të bashkëngjitë fletëkthesën që dëshmon se kur e ka pranuar parashtruesi Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [ARJ-UZVP. nr. 82/2021], të 26 gushtit 2021.
10. Më 4 shkurt 2022, Gjykata Themelore dorëzoi në Gjykatë dosjen e plotë të lëndës duke përfshirë edhe fletëkthesën e kërkuar.
11. Më 16 dhjetor 2022, gjyqtari Enver Peci dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç' rast filloi mandati i tij në Gjykatë.

12. Më 4 prill 2023, Gjykata shqyrtoi raportin paraprak të propozuar nga gjyqtari raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

13. Nga shkresat e lëndës rezulton se parashtruesi i kërkesës në cilësinë e importuesit në Deklaratën Unike Doganore [nr. R-21848/26.05.2016] deklaroi për doganim, në Zyrën e Brendshme Doganore në Prishtinë, makina të ndryshme fotokopjuese në vlerë prej 5,496.00 euro.
14. Zyra e Pranimit Qendror në Prishtinë kontestoi vlerën e mallit lëndor të Deklaratës Unike Doganore (DUD) të parashtruesit të kërkesës, duke caktuar vlerë të re doganore, ndërsa në procesin mbi konstatimin e gjendjes faktike konkludoi se malli lëndor është vlerësuar në bazë të metodës së gjashtë (6) të vlerësimit sipas nenit 35 të Kodit nr. 03/L-109 Doganor dhe të Akcizave të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kodi Doganor), përkatësisht duke u thirrur në çmime të referencave të doganës.
15. Më 7 qershor 2016, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë kundër Deklaratës Unike Doganore të 26 majit 2016, në Sektorin për rishqyrtimin e vendimeve të Doganës së Kosovës, për shkak të mosshqyrtimit të dokumenteve të transaksionit për vërtetimin e çmimit të mallrave dhe si rezultat i vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, duke theksuar se nuk është bërë krahasimi adekuat i mallit lëndor sipas Deklaratës Unike Doganore kontestuese. Parashtruesi i kërkesës, ndër të tjera, kërkoi që të merren parasysh dokumentet e transaksionit për të llogaritur obligimet doganore.
16. Më 12 korrik 2016, Dogana e Kosovës – Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (në tekstin e mëtejme: Dogana e Kosovës) përmes Aktvendimit [06/2470] refuzoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës, duke konstatuar se Zyra e Brendshme Doganore në Prishtinë ka vepruar drejtë kur ka kontestuar vlerën e mallit lëndor të deklaruar për zhdoganim sipas Deklaratës Unike Doganore kontestuese dhe ka aplikuar metodën e gjashtë (6) të vlerësimit, përkatësisht nenin 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës.
17. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesi i kërkesës ka paraqitur padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë kundër Aktvendimit [06/2470] të Doganës së Kosovës.
18. Më 13 qershor 2019, Gjykata Themelore, përmes Aktgjykimit [A. nr. 1235/16], aprovoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, duke anuluar Aktvendimin [06. 2/470] e 12 korrikut 2016 të Doganës së Kosovës dhe për pasojë ktheu rastin në rivendosje.
19. Gjykata Themelore, ndër të tjera, vlerësoi se Dogana e Kosovës “në arsyetimin e vendimit të kontestuar është kontradiktore në raport me konstatimet e dhëna, pasi që, siç shihet në faqen dy të vendimit kontestues e paditura, ndër të tjera, ka theksuar se lëndës i është bashkëngjitur edhe deklarata eksportuese, kurse në faqen tre të vendimit kontestues thekson se dokumentacioni përcjellës i mallit lëndor është vlerësuar si provë e pamjaftueshme, për arsye se në shkresat e lëndës mungon deklarata eksportuese. Gjykata konstaton se paditësi në procedurën administrative të ankesave tek e paditura por edhe në këtë konflikt administrativ përveç dokumentacionit përcjellës të mallit siç është fatura e mallit me nr.48383 e datës 17.05.2016, urdhërpagesa ndërkombëtare bankare e datës 23.05.2016, lëndës i ka bashkëngjitur edhe deklaratën eksportuese të datës 23 .05.2016, nga shteti eksportues nga Gjermania, mirëpo përkundër kësaj, e paditura nuk e ka shqyrtuar fare këtë dokumentacion por e ka rivlerësuar mallin lëndor, me pretendimin se në mes të eksportuesit dhe importuesit ekziston lidhje familjare e cila ka ndikuar në çmimin e mallit të deklaruar për zhdoganim”.

20. Gjykata Themelore gjithashtu theksoi se Dogana e Kosovës nuk ka qenë në gjendje të definojë shkallën e lidhjes familjare në mes të eksportuesit dhe importuesit dhe të provoj faktin se këtë pretendim për ekzistimin e lidhjeve familjare ia ka komunikuar parashtruesit të kërkesës dhe nëse këtij të fundit i është dhënë mundësia që të përgjigjet përkitazi me nenin 33 të Kodit Doganor dhe Akcizave të Kosovës.
21. Gjykata Themelore, në fund, përmes të njëjtit vendim kërkoi nga Sektori i rishqyrtimit të vendimeve të Doganës së Kosovës, që në riprocedurë të vlerësojë drejtë gjendjen faktike dhe të aplikojë drejtë dispozitat ligjore.
22. Më 23 shtator 2019, Dogana e Kosovës në riprocedurë përmes Aktvendimit [01.3.2.2/470/16] refuzoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës për rishqyrtimin e Deklaratës Unike Doganore, me të cilën i është kontestuar vlera e mallit lëndor të deklaruar për zhdoganim në Zyrën e Brendshme Doganore në Prishtinë, si të pabazuar, duke theksuar se: *“Zyra e Pranimit Qendror ka vepruar drejtë kur ka kontestuar vlerën e mallit lëndor pasi që vlera e mallit e deklaruar për zhdoganim nuk është vlera reale e paguar për mallin me qëllim të importit në vendin tonë për arsye se është deklaruar vlerë më e vogël se sa vlera reale e paguar apo që ka për t’u paguar për mallin e shitur për eksport, përkatësisht për import në vendin tonë, në vështrim të nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës”*.
23. Dogana e Kosovës përmes të njëjtit aktvendim theksoi se, duke pasur parasysh se parashtruesi i kërkesës në cilësinë e importuesit është në lidhje familjare me eksportuesin dhe i njëjti nuk ka dëshmuar se lidhja nuk ka ndikuar në çmim, ka gjetur një mospërputhje të madhe mes vlerës së deklaruar dhe importeve të ngjashme të subjekteve të tjera që e importojnë mallin e ngjashëm. Dogana e Kosovës konstatoi se nuk mund të lejojë që mallrat lëndore të zhdoganohen me çmime shpërfillëse në raport me vlerën e tregut.
24. Më 30 tetor 2019, parashtruesi i kërkesës inicioj konfliktin administrativ në Gjykatën Themelore kundër Aktvendimit [01.3.2.2/470/16] të Doganës së Kosovës, duke kërkuar që të **(i)** aprovohet padia në tërësi si e bazuar; **(ii)** të anulohet Aktvendimi [nr. 01.3.2.2/470/16], i 23 shtatorit 2019, i Doganës së Kosovës; dhe **(iii)** të detyrohet e paditura që të bëjë kthimin e mjeteve të paguara në emër të detyrimeve të importit.
25. Në kërkesëpadi, parashtruesi i kërkesës, ndër të tjera, theksoi se me rastin e deklarimit për doganim të mallrave ka prezantuar para zyrtarëve doganorë të gjitha dokumentet e nevojshme për të vërtetuar vlerën e transaksionit dhe vlerën reale të mallit, mirëpo të njëjtat nuk janë marrë parasysh nga zyrtarët doganorë të cilët kanë kontestuar vlerën e këtij malli dhe e kanë rivlerësuar atë sipas metodës së gjashtë (6) të rivlerësimit apo të dhënave të disponueshme, duke shkelur nenin 31 të Kodit Doganor dhe nenit 123 të Udhëzimit Administrativ (nr. 11/2009) për Implementimin e Kodit Doganor dhe të akcizave. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu theksoi se Dogana e Kosovës ka vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të gabuar, meqë nuk e ka vlerësuar faktin që malli është i përdorur me defekte teknike, siç mund të shihet nga neni 3 i Kontratës Lëndore, me të cilën përcaktohet se shitësi nuk i garanton blerësit, përkatësisht parashtruesit të kërkesës, lidhur me funksionalitetin e mallit lëndor.
26. Më 16 tetor 2020, Dogana e Kosovës parashtrroi përgjigje në padi, përmes të cilës e kundërshtoi në tërësi padinë e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar, për arsye se vendimi i atakuar është marrë konform dispozitave ligjore në fuqi dhe në mënyrë të drejtë. Ndër të tjera, Dogana e Kosovës theksoi se kontrata të cilës i referohet parashtruesi i kërkesës nuk specifikonte që aparatet janë me defekte dhe se parashtruesi nuk kishte arritur të dëshmonte një gjë të tillë.

27. Më 3 shkurt 2021, Gjykata Themelore në Prishtinë përmes Aktgjykimit [A. nr. 2574/19], refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës dhe la në fuqi Aktvendimin [nr.01.3.2.2/470/16] e Doganës së Kosovës, të 23 shtatorit 2019, me arsyetimin se nuk ka mundur të vërtetojë një gjendje tjetër faktike nga gjendja të cilën e ka konstatuar organi i paditur, përkatësisht Dogana e Kosovës. Gjykata Themelore, ndër të tjera, konstatoi se parashtruesi i kërkesës nuk ka dhënë shpjegime të mjaftueshme lidhur me çmimin e mallit lëndor të ofruar nga eksportuesi dhe se nuk ekzistojnë dëshmi të mjaftueshme që dëshmojnë se parashtruesi i kërkesës ka paguar vlerën e vërtetë të transaksionit të mallit lëndor të paguar me qëllim të eksportit, në vështrim të nenit 33 të Kodit Doganor.
28. Gjykata Themelore, ndër të tjera, vlerësoi se lidhja familjare e vërtetuar edhe gjatë procedurës së konfliktit administrativ ka ndikuar në çmimin e kontraktuar të mallit lëndor, fakte që dëshmohen nga kontrata e shitblerjes e nënshkruar nga personat përgjegjës, dhe pranimi i kësaj lidhje nga komunikimi me parashtruesin e kërkesës.
29. Më 7 prill 2021, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatë të Apelit, për shkak të **(i)** shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore; **(ii)** vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike; dhe **(iii)** aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, duke propozuar ndryshim/anulim të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore dhe anulim të aktvendimit të kontestuar të Doganës së Kosovës, si dhe të detyrohet e njëjta që parashtruesit të kërkesës t'ia kthejë shumën prej 14.544,11 euro, të paguara më tepër në emër të detyrimeve të importit, për shkak të rivlerësimit të mallrave.
30. Më 25 maj 2021, parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjykata e Apelit që, në pajtim me nenin 81.G [Seanca shqyrtimit] të Ligjit nr. 04/l-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr. 03/l-22, të mbaj seancën shqyrtuese.
31. Më 28 maj 2021, Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Çështje Administrative, përmes Aktgjykimit [AA. nr. 381/2021] refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe kërkesën për mbajtjen e seancës shqyrtuese, me arsyetimin se *“gjendja e vërtetuar faktike nga Gjykata Themelore nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore”* të parashtruesit të kërkesës, dhe se Aktgjykimi i Gjykatës Themelore nuk është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave procedurale dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Përveç kësaj, Gjykata e Apelit konstatoi se parashtruesi nuk ka dhënë shpjegime të mjaftueshme lidhur me çmimin e mallit lëndor të ofruar nga eksportuesi dhe se ky çmim nuk ka qenë i ndikuar nga lidhja familjare.
32. Më 8 korrik 2021, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Gjykatën Supreme, duke pretenduar shkelje të dispozitave procedurale, konstatim të gabuar të gjendjes faktike, aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, si rezultat i mosmbajtjes së seancës së shqyrtimit nga Gjykata e Apelit në pajtim me nenin 81.G të Ligjit nr. 04/l-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr. 03/l-222, duke kërkuar anulim të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore, dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.
33. Më 26 gusht 2021, Gjykata Supreme e Kosovës, përmes Aktgjykimit [ARJ-UZVP. nr. 82/2021], refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit.

34. Në arsyetim të këtij Aktgjykimi, Gjykata Supreme theksoi se “*gjykatat e instancës më të ulët nga provat e nxjerra në mënyrë të drejtë kanë pranuar konstatimet në arsyetimin e vendimit të kontestuar të paditurës se lidhja familjare e vërtetuar edhe gjatë procedurës së konfliktit administrativ, ka ndikuar në çmimin e kontraktuar të mallit, pasi që pronari i eksportuesit me importuesin janë në lidhje familjare, fakte të cilat janë dëshmuar me kontratën e shitblerjes të nënshkruar nga personat përgjegjës, dhe pranimi i kësaj lidhje nga komunikimi me paditësin. Nga kjo që u tha, gjykatat e instancës më të ulët kanë vërtetuar drejtë se e paditura me rastin e vendosjes, në mënyrë të saktë është thirrur në dispozitën e nenit 33, paragrafi 2 pika (a) të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës. Nga të gjitha që u thanë sipër, Gjykata Supreme ka konstatuar se pretendimet në kërkesën e paditësit për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor janë të pabazuara, sepse nuk kanë ndikim për vërtetim ndryshe të gjendjes faktike nga ajo që ka vërtetuar gjykata e shkallës së dytë. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, aktgjykimi i goditur i gjykatës së shkallës së dytë është i qartë dhe i kuptueshëm”.*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

35. Parashtruesi i kërkesës pretendon se përmes Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së. Parashtruesi i kërkesës specifikisht pretendon **(i)** shkelje të së drejtës në vendim të arsyetuar gjyqësor; **(ii)** mungesën e mbajtjes së seancës shqyrtuese nga Gjykata e Apelit; dhe **(iii)** konstatim/vlerësim të gabuar të provave/gjendjes faktike në rastin e parashtruesit të kërkesës.

Pretendimi për shkelje të të drejtës për vendim të arsyetuar

36. Përkitazi me pretendimet që ndërlidhen me mungesën e vendimit të arsyetuar gjyqësor, parashtruesi i kërkesës thekson se gjykatat e rregullta **(i)** nuk kanë trajtuar/arsyetuar pretendimet kryesore të ngritura në ankesë, respektivisht gjykatat e rregullta nuk kanë dhënë arsyetim lidhur me pretendimet e ngritura për lexim të pasaktë të transaksionit bankar, kontratës së shitblerjes, si dhe lidhjen familjare mes importuesit dhe eksportuesit; **(ii)** nuk kanë adresuar pretendimet përkitazi me shkeljen e ligjit, respektivisht shkeljen e nenit 33 të Kodit Doganor të Kosovës në lidhje me nenin 123 të Udhëzimit Administrativ për Implementimin e Kodit Doganor; **(iii)** shkeljen esenciale të dispozitave të LPK-së, respektivisht pikën n, paragrafi 2 i nenit 182, pasi që aktgjykimi është kontradiktor në vetvete dhe nuk jep arsye për faktet vendimtare; dhe **(iii)** konstatim të gabuar të gjendjes faktike si rezultat i vlerësimit të gabuar të provave të paraqitura lidhur me çmimin e transaksionit të mallit të importuar.

Pretendimi për mungesën e mbajtjes së seancës shqyrtuese nga Gjykata e Apelit

37. Përkitazi me pretendimin për mungesën e mbajtjes së seancës shqyrtuese, parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata e Apelit, në kundërshtim me nenin 81.G të Ligjit nr. 04/l-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr. 03/l-222, ka vendosur në rastin e tij pa “*hapur fare seancë të shqyrtimit me rastin e shqyrtimit të ankesës, dhe një shkelje të tillë nuk e ka vërejtur Gjykata Supreme, e detyruar të kujdeset sipas detyrës zyrtare*”.

Pretendimi për vlerësim të gabuar të provave

38. Përkitazi me pretendimin për vlerësim të gabuar të provave në rastin e tij, parashtruesi i kërkesës përgjatë pretendimeve të tij thekson se me anë të Deklaratës Unike Doganore (DUD), në Zyrën e Brendshme Doganore në Prishtinë, ka deklaruar për doganim në cilësinë e importuesit “*makina fotokopjuese të ndryshme të përdorura në gjithsej 3 emërtime, më detajisht sipas faturës dhe deklaratës doganore. (...) Me rastin e deklarimit për doganim të këtij malli, importuesi ka poseduar dhe prezantuar para zyrtarëve doganorë të gjitha dokumentet obligative për deklarimin e mallit dhe të tjera të nevojshme për ta bërë bindëse vlerën e transaksionit dhe vlerën reale të mallit, përkatësisht: DUD kontestues, fatura e mallit, në të cilin është evidentuar numri dhe data e faturës, malli, sasia për njësi dhe sasia totale, çmimi për njësi dhe shuma e përgjithshme, Urdhërpagesa bankare në emër të kësaj fature e dt. 23.05.2016, në të cilën është evidentuar numri i faturës së paguar, është përshkruar i tërë malli i paguar dhe vlera e paguar në përputhje me faturën, Deklarata eksportuese nga autoritetet doganore gjermane, në të cilën është evidentuar numri i faturës lëndore (48383), si dhe kontrata e shitblerjes së mallrave e dt. 02.05.2016, në të cilën është theksuar se kemi të bëjmë me mallra të përdorura, nga stoku për të cilat shitësi nuk garanton funksionalitetin, çka vërteton çmimin e lirë të tyre”, prova këto të cilat sipas parashtruesit nuk janë marrë parasysh nga organet administrative dhe gjykatat e rregullta në vendosjen e rastit të tij, dhe për pasojë pas asnjë provë materiale nuk kanë dëshmuar se parashtruesi i kërkesës nuk e ka paguar vlerën e transaksionit të mallit.*
39. Parashtruesi i kërkesës përgjatë pretendimeve të tij pohon se çështja e njëjtë e konfliktit administrativ gjendet për herë të dytë në gjykatat e rregullta. Herën e parë, me anë të Aktgjykimit [A. nr. 1235/16] të Gjykatës Themelore, të 13 qershorit 2019, janë pranuar si të harmonizuara dokumentet e transaksionit të prezantuara nga parashtruesi i kërkesës dhe është konstatuar se lidhja familjare vetvetiu nuk konstaton çmim joreal të shitblerjes. Në këtë kontekst, parashtruesi i kërkesës thekson: “*Ju lutem të keni parasysh se kemi të bëjmë me të njëjtën lëndë me të njëjtat dokumente, për të cilat e paditura në procedurën e rivendosjes nuk ka dhënë arsyetime dhe prova të tjera për të refuzuar kërkesën e paditësit (...) Siç mund të shihet për të njëjtën çështje në dy herë të shqyrtimit të çështjes nga gjykata, për të njëjtat dokumente, kemi qëndrime të ndryshme, prandaj konsiderojmë se kjo mënyrë gjykimi është absurde dhe arbitrare në dëm të paditësit*”.
40. Parashtruesi i kërkesës, ndër të tjera, shton se “*transaksioni bankar i datës 23 maj 2016, me vlerë prej 5,496.00 euro është lexuar si në mospërputhje me faturën nr.48383, me arsyetimin se nuk përshkruan tërë mallin por vetëm një pjesë të tij dhe kjo nuk paraqet vlerësim të gabuar të provës dhe të gjendjes faktike, por paafësi të gjyqtarit për të parë përmbajtjen e saktë të këtij dokumenti, prandaj konsiderojmë se konsiston në proces të parregullt gjyqësor, sepse siç mund të shihet në transfer bankar janë përshkruar tri pozicionet e mallrave si në faturë, është theksuar sasia e tyre dhe vlera e përgjithshme e transferit në përputhje me faturën*”.
41. Përfundimisht, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata: (i) të deklarojë kërkesën të pranueshme; (ii) të konstatojë se ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së; (iii) të shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin [ARJ. nr. 45/2022] të 13 qershorit 2022 i Gjykatës Supreme.

Dispozitat përkatëse kushtetuese dhe ligjore

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

[...]”

KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Neni 6

(E Drejta për një proces të rregullt)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

[...]”

KODI Nr. 03/L-202 DOGANOR DHE I AKCIZAVE NË KOSOVË

Kapitulli 2

Origjina e Mallrave

Seksioni 2

Origjina preferenciale e mallrave

Neni 31

“Rregullat mbi origjinën preferenciale do të caktojnë kushtet për fitimin e origjinës që duhet t'i plotësojnë mallrat për të përfituar nga masat e përmendura në nenin 24 (3) (2).

Këto rregulla do të caktohen në marrëveshjet e përmendura me nenin 24 (3) (2)”.

Kapitulli 3

Vlera e mallrave për qëllime doganore

Neni 33

“1. Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaksionit, që paraqet çmimin vërtetë të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, i përshtatur, sipas nevojës, në përputhje me nenet 36 dhe 37, me kusht që:

- a) Nuk ekzistojnë kufizime për disponimin ose shfrytëzimin e mallrave nga blerësi, përveç atyre kufizimeve të cilat: - Janë vendosur ose kërkohen me ligj prej autoriteteve publike në Kosovë, - Kufizojnë hapësirën gjeografike në të cilën mallrat mund të rishiten ose - Kryesisht nuk ndikojnë në vlerën e mallrave;
- b) Shitja ose çmimi nuk janë objekt i disa kushteve apo shqyrtimeve të mëvonshme për shkak të të cilave nuk mund të caktohet vlera lidhur me mallrat që vlerësohen;
- c) Asnjë pjesë e të ardhurave të nxjerra nga çdo rishitje, posedim ose përdorim të mëvonshëm të mallrave nga blerësi nuk i kthehet drejtpërdrejt ose tërthorazi shitësit, përveç rastit kur mund të bëhet një përshtatje e nevojshme në përputhje me nenin 36, dhe
- d) Blerësi dhe shitësi nuk janë në lidhje ose kur blerësi dhe shitësi janë në lidhje, vlera e transaksionit do të jetë e pranueshme për qëllime doganore sipas paragrafit 2.

2. Për qëllime të paragrafit 1, vlen me sa vijon:

- a) Për të përcaktuar nëse vlera e transaksionit është e pranueshme, fakti që blerësi dhe shitësi janë në lidhje, nuk paraqet vetvetiu një arsye të mjaftueshme për të konsideruar vlerën e transaksionit si të papranueshme. Sipas nevojës, shqyrtohen rrethanat e shitjes dhe pranohet vlera e transaksionit, me kusht që lidhja ndërmjet tyre të mos ketë ndikuar në çmim. Nëse, në bazën e të dhënave të ofruara nga deklaruesi ose të marra nga burimet e tjera, dogana ka arsye të dyshojë se kjo lidhje ka ndikuar në çmim, ajo, ia komunikon arsyet deklaruesit, të cilit i jepet një mundësi për t'u përgjigjur. Me kërkesë të deklaruesit, arsyet i komunikohen me shkrim.
- b) Në një shitje ndërmjet personash në lidhje, vlera e transaksionit pranohet dhe mallrat vlerësohen në përputhje me paragrafin 1, kur deklaruesi provon që kjo vlerë është e përafërt me njërin nga vlerat e mëposhtme, që paraqiten në të njëjtën kohë apo përafërsisht në të njëjtën kohë:
 - (i) vlerës së transaksionit të mallrave identike ose të ngjashme të shitura për eksport në Kosovë ndërmjet blerësve dhe shitësve që nuk janë në lidhje;
 - (ii) vlerës doganore të mallrave identike ose të ngjashme, siç përcaktohet me nenin 34 (2) (c);
 - (iii) vlerën doganore të mallrave identike ose të ngjashme, siç përcaktohet nën nenin 34 (2) (d).

Në zbatimin e kriterëve të sipërpërmendura, duhet pasur parasysh dallimet që shfaqen me nivelet komerciale, nivelet sasiore, elementet e numëruara në nenin 36 dhe shpenzimet të cilat i bartë shitësi për atë shitblerje, ku shitësi dhe blerësi nuk janë në lidhje dhe kur ato shpenzime nuk janë të bartura nga shitësi në shitblerje në të cilën blerësi dhe shitësi janë në lidhje.

- c) Kriteret e vendosura në nënparagrafin (b) përdoren me kërkesë të deklaruesit dhe vetëm për qëllime krahasimi. Nuk mund të vendosen vlera zëvendësuese sipas nënparagrafit në fjalë.

3. Çmimi vërtetë i paguar apo i pagueshëm është pagesa e plotë e bërë ose që duhet bërë nga blerësi për shitësin ose në dobi të këtij të fundit për mallin e importuar dhe që përfshin të gjitha pagesat e bëra ose që duhen bërë, si kusht i shitjes së mallrave të importuara nga blerësi për shitësit, ose nga blerësi për një palë të tretë për ta përmbushë obligimin ndaj shitësit. Pagesa mund të mos bëhet patjetër në formën e transferit të parave. Pagesa mund të bëhet me anë të letrave të kredisë ose ndonjë mjeti tjetër të dakorduar të pagesës dhe mund të bëhet drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë.

Veprimtaritë, duke përfshirë veprimtaritë e marketingut, të ndërmarrë nga blerësi në llogari të vet, të tjera nga ato për të cilat janë përmendur me nenin 36, që parashikojnë një përshtatje, nuk konsiderohen se janë një pagesë e tërthortë, që i bëhet shitësit, edhe pse mund të konsiderohen se janë në dobi të shitësit ose janë ndërmarrë në marrëveshje me shitësin dhe kostoja e tyre nuk do t'i shtohet çmimit vërtetë të paguar ose të pagueshëm gjatë përcaktimit të vlerës doganore të mallrave të importuara”.

Neni 35

“1. Kur vlera doganore e mallrave të importuara nuk mund të përcaktohet në bazë të nenit 33 ose 34, do të përcaktohet në bazën e të dhënave të disponueshme në Kosovë, duke përdorë metoda të arsyeshme në përputhje me parimet dhe dispozitat e përgjithshme:

- Marrëveshjen për implementimin e nenit 7 të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tarifat dhe Tregtinë e vitit 1994;.

- Neni 7 të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tarifat dhe Tregtinë e vitit 1994; - Dispozitave të këtij kreu.

2. Në rastet kur zbatohet paragrafi 1, asnjë vlerë doganore nuk mund të përcaktohet mbi bazën e:

- a) Çmimit të shitjes së mallrave të prodhuara në Kosovë;
- b) Një sistemi i cili për qëllime doganore parashikon pranimin e vlerës më të lartë midis dy vlerave alternative;
- c) Çmimit të mallrave në tregun vendor të vendit eksportues;
- d) Kostos së ndryshme të prodhimit nga vlerat e përlllogaritura që janë përcaktuar për mallra identike apo të ngjashme në përputhje me nenin 33 (2) (d);
- e) Çmimeve për eksport në një vend tjetër nga ai i Kosovës;
- f) Vlerave doganore minimale ose
- g) Vlerave arbitrare ose fiktive”.

LIGJI NR. 04/L-118 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 03/L-006 PËR PROCEDURËN KONTESTIMORE

Neni 182

“182.1 Shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore ekziston në qoftë se gjykata gjatë procedurës nuk e ka zbatuar apo ka zbatuar në mënyrë jo të drejtë ndonjë dispozitë të këtij ligji, kurse kjo ka pasur apo ka mundë të ketë ndikim në nxjerrjen e aktgjykimit të ligjshëm e të drejtë.

[...]

n) në qoftë se aktgjykimi ka të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohen, e sidomos në qoftë se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm apo kontradiktor me vetvete ose me arsyet e aktgjykimit, apo nëse aktgjykimi nuk ka fare arsye apo në të nuk janë treguar fare arsye për faktet vendimtare, ose ato arsye janë të paqarta, ose kontradiktore, ose nëse për faktet vendimtare ekzistojnë kundërthënie midis asaj që në arsyet e aktgjykimit thuhet për përmbajtje të

dokumentit ose të procesverbalit për thëniet e dhëna në procedurë dhe të vet atyre dokumenteve ose të procesverbalit;
o) në qoftë se me aktgjykim është tejkaluar kërkesëpadia”.

Neni 190

190.2 Gjykata e shkallës së dytë duhet ta caktoj shqyrtimin e çështjes kur vlerëson se për konstatimin e gjendjes faktike, saktësisht dhe plotësisht, duhet vërtetuar fakte të reja dhe marrë prova të reja nën kushtet e nenit 180 paragrafët 1 dhe 2 të këtij ligji.

Neni 399

399.1 Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigjja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia.

399.2 Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura.

LIGJI Nr. 04/L-102 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR ADMINISTRATËN TATIMORE DHE PROCEDURAT Nr. 03/L-222

Neni 81.G Seanca e shqyrtimit

“1. Divizioni Fiskal i Departamentit Administrativ të Gjykatës Themelore dhe Gjykata e Apelit **duhet të mbajnë seanca publike ku palët dëgjohen dhe provat shqyrtohen.**

2. Gjykata mund të mbaj seanca të mbyllura, kur ekzistojnë arsye të duhura në lidhje me sigurinë dhe çështjet konfidenciale të përfshira”.

LIGJIT NR. 03/L-202 PËR KONFLIKTET ADMINISTRATIVE

Neni 7 Parimi i efikasitetit

Gjykata e zbaton konfliktin administrativ shpejtë dhe pa zvarritje, duke iu shmangur veprimeve dhe shpenzimeve të panevojshme, me çka e pamundëson keqpërdorimin dhe zvarritjen e realizimit të të drejtave të palëve, të pjesëmarrësve të tjerë në konflikt dhe vendimin e nxjerrë në afat të parashikuar.

Neni 38

1. Në konfliktet administrative gjykata vendos në seancë të hapur.

2. Gjykata vendos për gjendjen faktike përmes shqyrtimit verbal dhe vlerësimit të fakteve.

3. Në konfliktet administrative gjykata mund të vendosë në seancë të mbyllur në rast se mund të zbulohen faktet që kanë të bëjnë me jetën private të palëve, mbi sekretin shtetëror, profesional, tregtar dhe me adoptimin.

4. Palët, nëse ka nevojë edhe ekspertët dhe përkthyesit, duhet të jenë të pranishëm në seancën e mbyllur.

5. Gjykata mund të vendosë çështjen pa shqyrtim verbal, nëse ka fakte të mjaftueshme dhe kur palët kanë dhënë pëlqimin e tyre në formë të shkruar.

6. Për përjashtimin e publikut nga seanca, gjykata në bazë të vlerësimit të vet vendos me vendim procedural i cili u komunikohet palëve.

UDHËZIMI ADMINISTRATIV NR. 11/2209 PËR IMPLEMENTIMIN E KODIT DOGANOR DHE TË AKCIZAVE NË KOSOVË

KREU VI DEKLARIMET DOGANORE – PROCEDURA E RREGULLT

Kapitulli 1

Seksioni 4

Neni 123

Dokumentet që duhet bashkëngjitur deklaratës doganore

“1. Dokumentet në vijim duhet bashkëngjitur deklaratës doganore për vendosje në qarkullim të lirë:

- a) *fatura në bazë të së cilës deklarohet vlera doganore e mallrave, siç kërkohet sipas nenit 91 të këtij akti;*
- b) *Kur kërkohet sipas nenit 88 të këtij akti, deklarata për vlerat doganore të mallrave të deklaruarat i bëjnë në përputhje me kushtet e paraqitura në nenin e dhënë;*
- c) *Dokumentet e kërkuara për aplikimin e aranzhimeve preferenciale tarifore dhe masat e tjera që dalin nga rregullat ligjore të zbatueshme për mallrat e deklaruarat;*
- d) *Të gjitha dokumentet e tjera të kërkuara për aplikimin e dispozitave që rregullojnë lirin për qarkullim të lirë të mallrave të deklaruarat.*

2. Dogana mund të kërkojë që në momentin e paraqitjes së deklaratës të parashtrijë edhe dokumentet e transportit ose kur është rasti, paraqitjen e dokumenteve që lidhen me procedurën doganore të mëparshme.

Kur një artikull i vetëm paraqitet në dy ose më shumë paketime, dogana mund të kërkojë edhe paraqitjen e një liste paketime ose të një dokumenti të barasvlefshëm që tregon përmbajtjen e secilës prej paketimeve.

3. Kur malli i plotëson kushtet për lirim nga detyrimet importuese doganore, dokumentet e përmendura në paragrafin 1(a),(b) dhe (c) nuk duhet të kërkohen, përveç nëse dogana e konsideron të nevojshme për qëllim të zbatimit të dispozitave që rregullojnë vendosjen e mallrave në qarkullim të lirë”.

Pranueshmëria e kërkesës

42. Gjykata së pari vlerëson nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
43. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

44. Gjykata gjithashtu i referohet paragrafit 4 të nenit 21 [Parimet e përgjithshme] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejné edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme”.

45. Në vazhdim, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohet në Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47 (Kërkesa individuale)

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48 (Saktësimi i kërkesës)

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49 (Afatet)

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor ...”.

46. Në këtë drejtim, Gjykata fillimisht thekson se parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të paraqesë ankesë kushtetuese, duke u thirrur në shkelje të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij, që vlejné për individët dhe personat juridikë (shih, në këtë kontekst, rastin e Gjykatës [KI118/18](#), me parashtrues *Eco Construction sh.p.k.*, Aktvendim për papranueshmëri, i 10 tetorit 2020, paragrafi 29).

47. Ndërsa, për sa i përket përmbushjes së kriterëve të pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe Ligj e të shtjelluara më lart, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [ARJ. UZVP. nr. 82/2021], të 26 gushtit 2021 të Gjykatës Supreme pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.
48. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka sqaruar të drejtat dhe liritë që pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
49. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton që:
- "(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".*
50. Gjykata rikujton se rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, si dhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës (shih, rastin [KI04/21](#), parashtruese *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 majit 2021, paragrafi 26; shih gjithashtu rastin [KI175/20](#), parashtruese *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri, i 27 prillit 2021, paragrafi 37).
51. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si "*qartazi e pabazuar*" në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t'iu referohet të njëjtave si "*pretendime qartazi të pabazuara*". Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime "*të shkallës së katërt*"; (ii) pretendime që kategorizohen me një "*mungesë të dukshme ose evidente të shkëljes*"; (iii) pretendime "*të pambështetura apo të paarsyetuara*"; dhe në fund, (iv) pretendime "*konfuze dhe të paqarta*" (shih: më saktësisht për konceptin e papranueshmërisë mbi bazën e një kërkesë të vlerësuar si "*qartazi të pabazuar*", dhe specifikat e katër kategorive të lartcekura të pretendimeve të kualifikuara si "*qartazi të pabazuara*", shih rastin [KI04/21](#), cituar më lart, paragrafi 27, si dhe rastin [KI175/20](#), cituar më lart, paragrafi 38).
52. Në këtë kontekst, si dhe në vazhdim të tekstit, gjatë vlerësimit nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata fillimisht do të rikujtoj thelbin e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë (shih, rastin [KI04/21](#), cituar më lart, paragrafi 28).
53. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës në cilësinë e importuesit kishte blerë disa makina të ndryshme fotokopjuese jashtë vendit dhe përmes Deklaratës Unike Doganore [nr. R-21848/26.05.2016] në Zyrën e Brendshme Doganore në Prishtinë, i kishte

deklaruar për doganim vlerën e tyre prej 5, 496.00 euro. Kjo vlerë e prezantuar nga parashtruesi i kërkesës ishte kontestuar nga Zyra e Pranimit Qendror në Prishtinë, e cila duke u bazuar në nenin 35 të Kodit Doganor caktoi vlerë të re doganore. Pas ankimimit nga parashtruesi i kërkesës në Sektorin për rishqyrtimin e vendimeve të Doganës së Kosovës lidhur me vlerën e re doganore, Dogana e Kosovës përmes Aktvendimit [06/2470] të 12 korrikut 2016 refuzoi ankesën e parashtruesit dhe ka konfirmuar vendimin e Zyrës së Brendshme Doganore në Prishtinë. Pas ankimit, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [A. nr. 1235/16] anuloi Aktvendimin [06. 2/470] e 12 korrikut 2016 të Doganës së Kosovës, duke e kthyer rastin në rivendosje për shkak se arsyetimi i vendimit të kontestuar ishte kontradiktor në raport me konstatimet dhe kishte mungesë të arsytimit lidhur me provat materiale. Ndërsa, Dogana e Kosovës në riprocedurë përmes Aktvendimit [01.3.2.2/470/16] refuzoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës për rishqyrtimin e Deklaratës Unike Doganore, me të cilën i është kontestuar vlera e mallit lëndor të deklaruar për zhdoganim në Zyrën e Brendshme Doganore në Prishtinë, si të pabazuar, duke konfirmuar se kjo e fundit drejtë kishte konstatuar gjendjen faktike.

54. Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [A. nr. 2574/19] të 3 shkurtit 2021, pas inicimit të konfliktit administrativ nga parashtruesi i kërkesës, konfirmoi Aktvendimin [nr.01.3.2.2/470/16] e Doganës së Kosovës, të 23 shtatorit 2019, me arsyetimin se drejtë ishte vërtetuar gjendja faktike. Parashtruesi i kërkesës përmes ankesave drejtuar Gjykatës së Apelit dhe më pas asaj Supreme kontestonte përgjatë gjithë procesit gjyqësor gjendjen e vërtetuar faktike dhe aplikimin e të drejtës materiale nga gjykatat e rregullta. Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme përmes vendimeve të tyre konfirmuan Aktgjykimin [A. nr. 2574/19] e Gjykatës Themelore, të 3 shkurtit 2021, me arsyetimin se drejtë ishte vërtetuar gjendja faktike dhe drejtë ishte zbatuar e drejta materiale.
55. Parashtruesi i kërkesës i konteston para Gjykatës konstatimet e lartcekura të gjykatave të rregullta, respektivisht të Gjykatës Supreme, duke specifikuar se Aktgjykimi i kontestuar është i përfshirë në shkelje të së drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Gjykata rikujton se në lidhje me pretendimin e tij për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës pretendon mosarsyetim të vendimit gjyqësor dhe mungesën e mbajtjes së seancës dëgjimore në nivel të Gjykatës së Apelit.
56. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të KEDNJ-së, duke kontestuar mënyrën e të vërtetuarit të gjendjes faktike; shqyrtimin e gabuar të provave të paraqitura dhe mosadresimin e pretendimeve thelbësore të ngritura dhe shkeljen e nenit 33 të Kodit Doganor nga ana e gjykatave të rregullta gjatë vendosjes në rastin e tij. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta kanë dështuar të ofrojnë arsyetimin lidhur me pretendimet e tij për shqyrtim të pasaktë të provave të paraqitura, si transaksionin bankar dhe kontratën e shitblerjes lidhur me vlerën e paguar të mallit të importuar.
57. Në dritën e këtyre sqarimeve, Gjykata do të shqyrtojë në vazhdim pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të KEDNJ-së.

Pretendimet për shkelje të të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm

58. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimet e gjykatave të rregullta në rastin e tij kanë shkelur disa komponenta të të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm: **(I)** të drejtën për një vendim të arsyetuar; dhe **(II)** të drejtën për seancë

dëgjimore në nivel të Gjykatës së Apelit; si dhe (III) vlerësimin e gabuar të provave në rastin e tij.

I. Pretendimi për shkelje të të drejtës për një vendim të arsyetuar

59. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta përmes vendimeve të tyre kanë shkelur nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, me arsyetimin se nuk i kanë adresuar/arsyetuar pretendimet e ngritura para tyre.
60. Gjykata, në këtë aspekt, fillimisht do të shqyrtojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së sa i përket të drejtës për një vendim të arsyetuar. Për këtë qëllim, në vijim, Gjykata fillimisht (i) do t'i shtjellojë parimet e përgjithshme përkitazi me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor, siç është e garantuar përmes neneve të lartcekura të Kushtetutës dhe KEDNJ-së; dhe më pas, (ii) do t'i aplikojë të njëjtat në rrethanat e rastit konkret.
 - (i) *Parimet e përgjithshme përkitazi me të drejtën për një vendim të arsyetuar dhe të arsyeshëm gjyqësor*
61. Garancitë e përmbajtura në nenin 6, paragrafin 1 përfshijnë obligimin e gjykatave që të arsyetojnë mjaftueshëm vendimet e tyre me të vërtetë (shih, Aktgjykimin e GjEDNJ-së [H. kundër Belgjikës](#), kërkesa 8950/80, paragrafi 53, të 30 nëntorit 1987). Vendimi i arsyetuar u tregon palëve se rasti i tyre është shqyrtuar me të vërtetë.
62. Edhe pse gjykata vendore ka një liri të caktuar të vlerësimit në pranimin e argumenteve dhe vendosjen për lejin e provave, ajo gjithashtu ka edhe obligimin që të justifikojë veprimet e saj duke dhënë arsye për vendimet e saj (shih, Aktgjykimin e GjEDNJ-së [Suominen kundër Finlandës](#), kërkesa 37801/97, të 1 korrikut 2003, paragrafi 36; si dhe rastin [Carmel Saliba kundër Maltës](#), nr. 24221/13, Aktgjykim i 24 prillit 2017, paragrafi 73).
63. Gjykata më e ulët ose autoriteti shtetëror, nga ana tjetër, duhet të japin arsye dhe arsye të tilla të cilat do t'ua mundësojnë palëve të shfrytëzojnë në mënyrë efektive çdo të drejtë ekzistuese të ankesës (shih, rastin e GjEDNJ-së [Hirvisaari kundër Finlandës, nr. 49684/99](#), Aktgjykim i 25 dhjetorit 2001, paragrafi 30).
64. Neni 6, paragrafi 1 i detyron gjykatat të japin arsye për vendimet e tyre, por kjo nuk do të thotë se kërkohet përgjigje e detajuar lidhur me secilin argument (shih, Aktgjykimin e GjEDNJ-së, [Van de Hurk kundër Holandës](#), nr. 16034/90, Aktgjykim i 19 prillit 1994, paragrafi 61; [Garcia Ruiz kundër Spanjës](#), nr. 30544/96, Aktgjykim i 29 janarit 1990, paragrafi 26; Aktgjykimin [Perez kundër Francës](#), nr. 47287/99, Aktgjykim i 12 shkurtit 2004, paragrafi 81).
65. Nga natyra e vendimit që merr gjykata varet nëse Gjykata është e detyruar ta arsyetojë atë, dhe kjo mund të vendoset vetëm në dritën e rrethanave të rastit në fjalë: është e nevojshme të merren parasysh, ndër të tjera, llojet e ndryshme të parashtrësive që një palë mund t'ia paraqesë gjykatës, si dhe dallimet që ekzistojnë midis sistemeve juridike të vendeve në lidhje me dispozitat ligjore, rregullat zakonore, pozicionet juridike dhe paraqitjen dhe hartimin e aktgjyqimeve (shih, Aktgjykimin e GjEDNJ-së [Ruiz Toria kundër Spanjës, nr. 18390/91](#), Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 29; [Hiro Balani kundër Spanjës, nr. 18064/91](#), Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 27).
66. Megjithatë, nëse parashtrësia e një pale është vendimtare për rezultatin e procedurës, ajo kërkon që t'i përgjigjet në mënyrë specifike dhe pa vonesë (shih, Aktgjykimin e

GJEDNJ-së, [Ruiz Toria kundër Spanjës](#), cituar më lart, paragrafi 30; [Aktgjykimi Hiro Balani kundër Spanjës](#), cituar më lart, paragrafi 28).

67. Prandaj, gjykatat vendase janë të obliguara që:
- (a) të shqyrtojnë argumentet kryesore të palëve (shih, rastet e GJEDNJ-së, [Buzescu kundër Rumanisë, nr. 61302/00](#), Aktgjykim i 24 gushtit 2005, paragrafi 67; [Donadze kundër Gjeorgisë, nr. 74644/01](#), Aktgjykimi i 7 qershorit 2006, paragrafi 35);
 - (b) të shqyrtohen me shumë rigorozitet dhe kujdes të veçantë kërkesat në lidhje me të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë, KEDNJ dhe protokollat e saj (shih, rastet e GJEDNJ-së: [Fabris kundër Francës](#), cituar më lart, paragrafi 72; [Wagner dhe JMWL kundër Luksemburgut, nr. 76240/01](#), Aktgjykim i 28 qershorit 2007, paragrafi 96).
68. Neni 6, paragrafi 1, nuk kërkon që Gjykata Supreme të japë një arsyetim më të detajuar kur ajo thjesht zbaton një dispozitë të caktuar ligjore lidhur me bazën ligjore për refuzimin e ankesës sepse ajo ankesë nuk ka një perspektivë për sukses (shih, rastet e GJEDNJ-së, [Burg dhe të tjerët kundër Francës, nr. 34763/02](#), vendim i 28 janarit 2003; [Gorou kundër Greqisë \(nr. 2\), nr. 12686/03](#), vendim i 20 marsit 2009, paragrafi 41).
69. Në mënyrë të ngjashme, në një rast ku bëhet fjalë për një kërkesë që të lejohet parashtrimi i ankesës, që është një parakusht për procedurën e një gjykatë më e lartë, si dhe për të nxjerrë një aktgjykim të mundshëm, neni 6, paragrafi 1, nuk mund të interpretohet në atë mënyrë që të urdhërojë një arsyetim të detajuar të vendimit për refuzimin e kërkesës për parashtrimin e ankesës (shih, rastet e GJEDNJ-së, [Kukkonen kundër Finlandë \(nr. 2\), nr. 47628/06](#), Aktgjykim i 13 prillit 2009,) paragrafi 24; [Bufferne kundër Francës, nr. 54367/00](#), Vendim i 26 shkurtit 2002).
70. Përveç kësaj, kur refuzon një ankesë, Gjykata e Apelit, në parim, thjesht mund të pranojë arsyetimin e vendimit të dhënë nga gjykata më e ulët (shih, rastin [García Ruiz kundër Spanjës](#), cituar më lart, paragrafi 26; shih, në kundërshtim me këtë, aktgjykimin [Tatishvili kundër Rusisë, i 9 korrikut 2007, kërkesa nr. 1509/02](#)) paragrafi 62). Megjithatë, koncepti i procedurës së drejtë nënkupton që gjykata vendase që ka dhënë një shpjegim të ngushtë për vendimet e saj, qoftë duke përsëritur arsyetimet e dhëna më parë nga një gjykatë më e ulët ose në ndonjë mënyrë tjetër, në fakt merrej me çështje të rëndësishme brenda juridiksionit të saj, që do të thotë se nuk i pranoi thjesht dhe pa përpjekje shtesë konkluzionet e arritura nga gjykata më e ulët (shih, Aktgjykimin [Helle kundër Finlandës, nr. \(157/1996/776/977\)](#), Aktgjykim i 19 dhjetorit 1997, paragrafi 60). Kjo kërkesë është aq më e rëndësishme nëse pala në kontest nuk ka pasur mundësi t'i paraqesë argumentet e saj gojarisht në procedurën para gjykatës vendase.
71. Megjithatë, Gjykata e Apelit (në shkallën e dytë) të cilat kanë juridiksion për të hedhur poshtë ankesat e pabazuara dhe për të zgjidhur çështjet faktike dhe juridike në procedurën kontestimore, janë të obliguara të arsyetojnë se përse refuzuan të vendosin për ankesën (shih, rastin e GJEDNJ-së [Hansen kundër Norvegjisë, nr. 15319/09](#), Aktgjykim i 2 janarit 2015, paragrafët 77–83).
72. Përveç kësaj, GJEDNJ-ja nuk përcakton se ishte shkelur e drejta në një rast në të cilin nuk është dhënë një sqarim specifik në lidhje me një pohim që i referohej një aspekti të parëndësishëm të rastit, përkatësisht mungesës së nënshkrimit dhe vulës, që është një gabim i një natyre më shumë formale sesa materiale dhe ai gabim u korrigjua menjëherë

(shih, rastin *Mugoša kundër Malit të Zi*, nr. 76522/12, Aktgjykim i 21 shtatorit 2016, paragrafi 63).

(ii) Zbatimi i parimeve të përmendura për të drejtën për një vendim të arsyetuar dhe të arsyeshëm gjyqësor në rrethanat e rastit konkret

73. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e vendimeve të gjykatave të rregullta, respektivisht Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme, duke pretenduar shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të KEDNJ-së, duke kontestuar mënyrën e të vërtetuarit të gjendjes faktike; shqyrtimin e gabuar të provave të paraqitura dhe mosadresimin e pretendimeve thelbësore të ngritur, si dhe shkeljen e nenit 33 të Kodit Doganor nga ana e gjykatave të rregullta gjatë vendosjes në rastin e tij.
74. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta kanë dështuar të ofrojnë arsyetim lidhur me pretendimet e tij për shqyrtim të pasaktë të provave të paraqitura si transaksionin bankar dhe kontratën e shitblerjes lidhur me vlerën e paguar të mallit të importuar.
75. Prandaj, duke pasur parasysh pretendimin kryesor ankimor të parashtruesit të kërkesës, Gjykata konsideron se duhet të analizohet nëse gjykatat e rregullta, respektivisht Gjykata Supreme, kanë dhënë arsye të qarta dhe të mjaftueshme mbi të cilat i kanë mbështetur vendimet e tyre, të cilat rezultuan në refuzimin e ankesës së parashtruesit të kërkesës.
76. Përkitazi me pretendimet e parashtruesit të kërkesës, përkatësisht lidhur me pretendimin për shqyrtimin e pasaktë të provave të paraqitura dhe konstatimin e gabuar të gjendjes faktike përgjatë gjithë procesit gjyqësor, Gjykata vëren se të njëjtat ish-in trajtuar në mënyrë të detajuar nga gjykatat e rregullta.
77. Gjykata fillimisht rikujton se Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [A. nr. 2574/19] të 3 shkurtit 2021, duke trajtuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës, ndër të tjera, kishte theksuar si në vijim:

[...]

Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ gjykata nuk ka mundur të vërtetoj një gjendje tjetër faktike nga gjendja të cilën e ka konstatuar organi i paditur gjatë procedimit administrativ, për arsye se nuk ka qenë e mundur të vërtetohet se vlera e deklaruar për zhdoganim është vlerë reale e paguar për mallin me qëllim të importit në vendin tonë. Paditësi në padinë e tij dhe në seancën gjyqësore përmes të autorizuarit nuk ka dhënë shpjegime të mjaftueshme lidhur me çmimin e mallit lëndor të ofruar nga eksportuesi Flori Kopiersusteme-Gjermani, se ky çmim i mallit lëndor nuk ka ndikuar në lidhje ...”.

“[...] Gjykata nuk e konteston faktin se paditësi ka paraqitur dokumentacionin përcjellës të mallit lëndor për të dëshmuar vlerën reale të mallit lëndor, si: fatura e mallit lëndor, kontratën e shitjes, transferin bankar, deklaratën e shtetit eksportues, mirëpo përshkrimi i pagesës bankare dt.23.05.2016 Pro Credit Bank, nuk jep shpjegime të qarta se pagesa është bërë në tërësi për tërë sasinë e mallit lëndor, pasi që vlera faturale në shumën prej 5,496.00€ ka të bëjë vetëm për një produkt të mallit: Isamsung multi xpress 6545nx 150 copë, ndërsa për dy produktet tjera lexmark x463 100 copë dhe lexmark T652dn 124 copë, nuk është cekur ndonjë vlerë.

Në rastin konkret gjykata konsideron se nuk ekzistojnë dëshmi të mjaftueshme që dëshmojnë se paditësi ka paguar vlerën e vërtetë të transaksionit të mallit lëndor paguar me qëllim eksporti në vështirim të nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës 03/L-109. Nga shkresat e lëndës gjykata konstaton se paditësi nuk ka prezantuar dokumentacion të kompletuar dhe të harmonizuar për të dëshmuar se vlera e deklaruar është vlerë reale e transaksionit.

Megenëse nga provat e administruara gjykata nuk ka mundur të vërtetoj se paditësi i ka paguar eksportuesit vlerën reale të mallit lëndor sipas faturës përcjellëse të mallit, gjykata vlerëson se e paditura ka vepruar drejt kur me vendimin kontestues ka konfirmuar rivlerësimin e mallit lëndor nga Zyra e pranimit qendror, duke aplikuar metodën e 6 të vlerësimit neni 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave përkatësisht të dhënave të disponueshme që disponon Dogana e Kosovës, respektivisht importet e mallrave të ngjashme të zhdoganuara në periudhë të afërt kohore me mallin kontestues (DUD-at RI266/03.03.2016, RI6488/27.04.2016 dhe R6332117.3.2016).

[...] Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ, Gjykata gjithashtu konstatoi se paditësi nuk ka prezantuar dokumentacion të kompletuar për të dëshmuar se vlera e deklaruar paraqet vlerën reale të transaksionit, në kuptim të nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave”.

78. Gjykata gjithashtu rikujton se Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [AA. nr. 381/2021] të 28 majit 2021, në kontekst të këtij pretendimi specifik të parashtruesit të kërkesës, kishte theksuar si në vijim:

[...] Po ashtu, gjykata e shkallës së parë me të drejtë nuk e ka kontestuar faktin se paditësi ka paraqitur dokumentacionin përcjellës të mallit lëndor për të dëshmuar vlerën reale të tij, si fatura e mallit lëndor, kontratën e shitjes, transferin bankar, deklaratën e shtetit eksportues, mirëpo përshkrimi i pagesës bankare të datës 23.05.2016 Pro Credit Bank, nuk jep shpjegime të qarta se pagesa është bërë në tërësi për tërë sasinë e mallit lëndor, pasi që vlera faturale në shumën prej 5,496.00 €, ka të bëjë vetëm për një produkt të mallit: një samsung multi xpress 6545nx 150 copë, ndërsa dy produkte tjera lexmark x463, 100 copë, dhe lexmark T652dn, 124 copë, nuk është cekur ndonjë vlerë. Prandaj, nga provat e administruara gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka pranuar konstatimet në arsyetimin e vendimit kontestues të të paditurës se lidhja familjare e vërtetuar edhe gjatë procedurës së konfliktit administrativ, ka ndikuar në çmimin e kontraktuar të mallit lëndor, pasi që pronari i eksportuesit me importuesin janë në lidhje familjare, fakte që dëshmojnë me kontratën e shitblerjes të nënshkruar nga personat përgjegjës, dhe pranimi i kësaj lidhje nga komunikimi me paditësin. Andaj, gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka konstatuar se e paditura drejtë iu ka referuar dispozitës së nenit 33, par.2 pika a) të KDAK-së, e po ashtu duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, kjo gjykatë gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur është bazuar në dispozitat e LKA-së, Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, si dhe Kodit nr.03/L-109 Doganor dhe të Akcizave në Kosovë.

79. Në fund, Gjykata Supreme e Kosovës, përmes Aktgjykimit [ARJ-UZVP. nr. 82/2021] të 26 gushtit 2021, në trajtim të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, kishte sqaruar si në vijim:

“Paditësi në padinë e tij as gjatë procesit gjyqësor nuk ka ofruar sqarime të mjaftueshme lidhur me çmimin e mallit lëndor të ofruar nga importuesi - Flori

kopiersysteme-Gjermani. Në fakt, gjykata e shkallës së parë nuk e ka kontestuar faktin se paditësi ka paraqitur dokumentacionin përcjellës për mallin lëndor për të dëshmuar vlerën e tij reale siç janë, fatura e mallit lëndor, kontrata e shitblerjes, transaksioni bankar, deklarata eksportuese. Mirëpo, sipas mendimit të kësaj gjykate, përshkrimi i pagesës bankare i datës 23.05.2016 Pro Credit bank, nuk jep sqarime të qarta se pagesa është bërë në tërësi dhe për sasinë e plotë të mallit lëndor, pasi që vlera faturale në shumën prej 5,496.00€, ka të bëjë vetëm për një artikull të mallit - një samsung multi express 6545nx 150 copë, ndërsa për dy produktet tjera -lexmark x463, 100 copë, dhe lexmark T652dn, 124 copë, nuk është cekur asnjë vlerë. Prandaj, sipas mendimit të kësaj gjykate, gjykatat e instancës më të ulët nga provat e nxjerra në mënyrë të drejtë kanë pranuar konstatimet në arsyetimin e vendimit të kontestuar të të paditurës se lidhja familjare e vërtetuar edhe gjatë procedurës së konfliktit administrativ, ka ndikuar në çmimin e kontraktuar të mallit, pasi që pronari i eksportuesit me importuesin janë në lidhje familjare, fakte të cilat janë dëshmuar me kontratën e shitblerjes të nënshkruara nga personat përgjegjës, dhe pranimi i kësaj lidhje nga komunikimi me paditësin. Nga kjo që u tha, gjykatat e instancës më të ulët kanë vërtetuar drejtë se e paditura me rastin e vendosjes, në mënyrë të saktë është thirrur në dispozitën e nenit 33, paragrafi 2 pika (a) të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës”.

80. Tutje, Gjykata Supreme përmes të të njëjtit vendim kishte konstatuar se “Në arsyetimin e aktgjykimit të kontestuar janë dhënë mjaft arsye lidhur me faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Gjykata vlerëson se e drejta materiale është aplikuar drejtë dhe nuk është shkelur ligji në dëm të paditësit”.
81. Në këtë aspekt, Gjykata konsideron se gjykatat e rregullta, në rrethanat e rastit konkret, kishin trajtuar dhe arsyetuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës. Të njëjtat, kishin trajtuar pretendimet thelbësore të parashtruesit të kërkesës dhe kishin sqaruar se **(i)** parashtruesi i kërkesës kishte dështuar që të mbështetë me prova se vlera e deklaruar për doganim është vlera reale e mallit që e kishte paguar për import; **(ii)** dokumentacioni i dorëzuar nuk dëshmonte mjaftueshëm se vlera e paguar përfshinte pagesën për të gjithë mallin e prezantuar për doganim; **(iii)** si dhe në mungesë të provave lidhur me pagesën e mallit të prezantuar, gjykatat e rregullta në mënyrë të drejtë ishin referuar dhe kishin aplikuar nenin 33 dhe 35 të Kodit Doganor.
82. Nga sa më sipër, Gjykata konsideron se gjykatat e rregullta përmes vendimeve të tyre kanë dhënë arsye bindëse dhe të mjaftueshme duke shtjelluar në detaje bazën ligjore mbi të cilën Dogana e Kosovës kishte bazuar vendimin e saj, duke iu referuar nenit 33 dhe 35 të Kodit Doganor.
83. Në këtë drejtim, Gjykata do t’ i referohet edhe nenit 33 të Kodit Doganor, i cili parasheh se “Për të përcaktuar nëse vlera e transaksionit është e pranueshme, fakti që blerësi dhe shitësi janë në lidhje, nuk paraqet vetvetiu një arsye të mjaftueshme për të konsideruar vlerën e transaksionit si të papranueshme. Sipas nevojës, shqyrtohen rrethanat e shitjes dhe pranohet vlera e transaksionit, me kusht që lidhja ndërmjet tyre të mos ketë ndikuar në çmim. Nëse, në bazën e të dhënave të ofruara nga deklaruesi ose të marra nga burimet e tjera, dogana ka arsye të dyshojë se kjo lidhje ka ndikuar në çmim, ajo, ia komunikon arsyet deklaruesit, të cilit i jepet një mundësi për t’u përgjigjur. Me kërkesë të deklaruesit, arsytet i komunikohen me shkrim”.
84. Gjykata, nga të gjitha shtjellimet e sipërtheksuara, në rrethanat e rastit konkret, konsideron se parashtruesi i kërkesës thjeshtë është i pakënaqur me rezultatin e procedurës pranë Gjykatës Supreme. Megjithatë, pakënaqësia e tij nuk mund vetvetiu të ngrejë një pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave dhe lirive

themelore të garantuara me Kushtetutë (shih, rastin e GJEDNJ-së [Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë](#), Aktgjykim i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).

85. Përveç kësaj, Gjykata konstaton se Aktgjykimi i kontestuar, përmban arsyetim logjik dhe sqaron me saktësi dhe referencë të qartë ligjore se përse në rastin e parashtruesit të kërkesës është aplikuar dispozita 33 e Kodit Doganor (shih, rastet e GJEDNJ-së [Ruiz Toria kundër Spanjës](#), cituar më lart, paragrafi 30; [Hiro Balani kundër Spanjës](#), cituar më lart, paragrafi 28).
86. Prandaj, Gjykata konstaton që parashtruesi i kërkesës ka pasur mundësi të përfitojë nga procedura kontradiktore dhe se ka pasur mundësi që në fazat e ndryshme të procedurës t'i paraqet pretendimet dhe provat të cilat i ka konsideruar si të rëndësishme për rastin e tij; ka pasur mundësinë për t'i kundërshtuar pretendimet dhe provat e paraqitura nga pala kundërshtare në mënyrë efektive; gjykatat e rregullta i kanë dëgjuar dhe shqyrtuar të gjitha pretendimet e tyre, e të cilat, shikuar objektivisht, kanë qenë të rëndësishme për zgjidhjen e lëndës; dhe se arsyet faktike dhe juridike për vendimin e kontestuar janë paraqitur në detaje, dhe për këtë arsye procedura, e marrë në tërësi, ishte e drejtë (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 21 janarit 1999, [García Ruiz kundër Spanjës](#), nr. 30544/96, paragrafët 29 dhe 30; shih gjithashtu rastin [KI22/19](#), parashtrues *Sabit Ilazi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 qershorit 2019, paragrafi 42; si dhe rasti [KI128/18](#), i cituar më lart, paragrafi 58).
87. Si përmbledhje, lidhur me pretendimin për shkelje të së drejtës për një vendim të arsyetuar dhe të arsyeshëm gjyqësor, Gjykata konkludon se Gjykata Supreme: **(i)** ka dhënë bazën juridike dhe ka shpjeguar me qartësi se përse në rastin e parashtruesit të kërkesës është zbatuar neni 33 i Kodit të Doganës; **(ii)** Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme përmban lidhje logjike ndërmjet bazës juridike, arsyetimit dhe përfundimeve të nxjerra; **(iii)** si rrjedhojë logjike ndërmjet bazës juridike, arsyetimit dhe përfundimeve ka rezultuar se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme, ARJ. UZVP. nr. 82/2021, e plotëson kushtin e një vendimi të arsyetuar dhe të arsyeshëm gjyqësor (shih, rastet e GJEDNJ-së, [Buzescu kundër Rumanisë](#), nr. 61302/00, Aktgjykim i 24 gushtit 2005, paragrafi 67; [Donadze kundër Gjeorgisë](#), nr. 74644/01, Aktgjykim i 7 qershorit 2006, paragrafi 35).
88. Prandaj, Gjykata konkludon se pretendimet për shkelje të së drejtës për një vendim të arsyetuar dhe të arsyeshëm gjyqësor, janë (i) pretendime që i takojnë kategorisë së “*të pambështetura apo të paarsyetuara*”; dhe si të tilla, këto pretendime të parashtruesit të kërkesës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

II. Pretendimi për mungesën e seancës dëgjimore në Gjykatën e Apelit

89. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata e Apelit ka nxjerrë Aktgjykim në rastin e tij, pa një seancë dëgjimore në shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
90. Gjykata, në këtë aspekt, fillimisht do të shqyrtojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së për shkak të mungesës së një seance dëgjimore në nivel të Gjykatës së Apelit. Për këtë qëllim, në vijim, Gjykata fillimisht (i) do t'i shtjellojë parimet e përgjithshme përkitazi me të drejtën në një seancë dëgjimore siç është e garantuar përmes neneve të lartcekura të Kushtetutës dhe KEDNJ-së; dhe më pas, (ii) do t'i aplikojë të njëjtat në rrethanat e rastit konkret.

(i) *Parimet e përgjithshme përkitazi me të drejtën për një seancë dëgjimore*

91. Karakteri publik i procedurave para organeve gjyqësore të referuara në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, mbron palët ndërgjyqëse nga administrimi i drejtësisë në fshehtësi, në mungesë të një shqyrtimi publik. Publiciteti i procedurave gjyqësore është gjithashtu një nga mekanizmat kryesorë përmes të cilës ruhet besimi në drejtësi. Një parim i tillë, për më tepër, kontribuon në arritjen e qëllimeve të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, për një proces të drejtë gjyqësor, garantimi i të cilit është një nga parimet themelore të çdo shoqërie demokratike të mishëruara në Kushtetutë dhe KEDNJ (shih, Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 30 prillit 2020 për nenin 6 të KEDNJ-së, E drejta për një proces të drejtë, pjesa civile, IV. Kriteret Procedurale; B. Dëgjimi Publik, paragrafët 381 deri 404 dhe referencat e përdorura aty).
92. Gjykata thekson se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së ka vendosur parimet themelore përkritazi me të drejtën për një seancë dëgjimore. Bazuar në këtë praktikë gjyqësore, Gjykata gjithashtu ka përcaktuar parimet dhe përjashtimet përkatëse, bazuar në të cilat vlerësohet domosdoshmëria e mbajtjes së një seance dëgjimore, varësisht nga rrethanat e rasteve përkatëse. Rishtazi, përmes një numri aktgjykimesh, Gjykata ka vënë theks në këto parime, duke konstatuar shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së për shkak të mungesës së një seance dëgjimore para DHPGJS-së, përkatësisht edhe para Kolegjit të Specializuar edhe Kolegjit të Apelit, me rastin e përcaktimit të të drejtave të punëtorëve të ish-ndërmarrjes “Agimi”, pas privatizimit të të njëjtës, të cilave raste Gjykata në vijim do t’ ju referohet si rastet e Gjykatës të ish-ndërmarrjes “Agimi” (shih 5 (pesë) aktgjykimet në rastet e ish-ndërmarrjes “Agimi”): [KI145/19](#), [KI146/19](#), [KI147/19](#), [KI149/19](#), [KI150/19](#), [KI151/19](#), [KI152/19](#), [KI153/19](#), [KI154/19](#), [KI155/19](#), [KI156/19](#), [KI157/19](#) dhe [KI 159/19](#), me parashtrues *Et-hem Bokshi dhe të tjerët*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-13-0181-A0008, të 29 gushtit 2019, Aktgjykim i 10 dhjetorit 2020; [KI160/19](#), [KI161/19](#), [KI162/19](#), [KI164/19](#), [KI165/19](#), [KI166/19](#), [KI167/19](#), [KI168/19](#), [KI169/19](#), [KI170/19](#), [KI171/19](#), [KI172/19](#), [KI173/19](#) dhe [KI178/19](#), me parashtrues *Muhamet Këndusi dhe të tjerët*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-13-0181-A0008, të 29 gushtit 2019, Aktgjykim i 27 janarit 2021; [KI181/19](#), [KI182/19](#) dhe [KI183/19](#), me parashtrues *Fllanza Naka, Fatmire Lima dhe Leman Masar Zhubi*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-13-0181-A0008, të 29 gushtit 2019; Aktgjykim i 27 janarit 2021; [KI220/19](#), [KI221/19](#), [KI223/19](#) dhe [KI234/19](#), me parashtruese *Sadete Koca Lila dhe të tjerët*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-13-0181-A0008, të 29 gushtit 2019, Aktgjykim i 25 marsit 2021; dhe [KI186/19](#); [KI187/19](#), [KI200/19](#) dhe [KI208/19](#), me parashtrues *Belkize Vula Shala dhe të tjerët*; Aktgjykim i 28 prillit 2021). Gjykata, gjatë elaborimit të parimeve të shtjelluara të konfirmuara përmes aktgjykimeve të lartcekura të Gjykatës dhe aplikimit të këtyre në rrethanat e rastit konkret do t’i referohet Aktgjykimit të saj të parë në lidhje me ish-ndërmarrjen “Agimi”, gjegjësisht rasteve [KI145/19](#), [KI145/19](#), [KI146/19](#), [KI147/19](#), [KI149/19](#), [KI150/19](#), [KI151/19](#), [KI152/19](#), [KI153/19](#), [KI154/19](#), [KI155/19](#), [KI156/19](#), [KI157/19](#) dhe [KI159/19](#), parashtrues *Et-hem Bokshi dhe të tjerët*).
93. Në parim, palët ndërgjyqëse kanë të drejtë për një seancë dëgjimore publike, por një detyrim i tillë nuk është absolut. GJEDNJ ka theksuar se në procedurat para një gjykate të shkallës së parë dhe të vetme, e drejta për një seancë dëgjimore është e garantuar përmes paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNJ-së (shih, ndër të tjera, rastet e GJEDNJ-së,

Fredin kundër Suedisë (nr. 2), kërkesa nr. 18928/91, Aktgjykim i 23 shkurtit 1994, paragrafët 21-22; Allan Jacobsson kundër Suedisë (nr. 2), kërkesa nr. (8/1997/792/993), Aktgjykim i 19 shkurtit 1998, paragrafi 46; Göç kundër Turqisë, kërkesa nr. 36590/97, Aktgjykim i 11 korrikut 2002, paragrafi 47; dhe Selmani dhe të tjerët kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, kërkesa nr. 18928/91, Aktgjykim i 9 shkurtit 2017, paragrafët 37-39). Përjashtim nga ky parim i përgjithshëm, përbëjnë rastet në të cilat “ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore” në shkallën e parë dhe të vetme (shih, në këtë aspekt, rastet e GJEDNJ-së, Hesse-Anger dhe Anger kundër Gjermanisë, Vendim i 17 majit 2001; dhe Mirovni Institut kundër Sllovenisë, kërkesa nr. 32303/13) Aktgjykim i 13 marsit 2018, paragrafi 36; e shih, gjithashtu, Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 30 prillit 2020 për nenin 6 të KEDNJ-së, E drejta për një proces të drejtë, pjesa civile, IV. Kriteret Procedurale; B. Dëgjimi Publik, paragrafët 382 dhe referencat e përdorura aty). Karakteri i rrethanave të tilla të jashtëzakonshme buron nga natyra e çështjeve që ngërthen një rast, për shembull, rastet që kanë të bëjnë ekskluzivisht me çështje ligjore ose janë të natyrës shumë teknike (shih, rastin e GJEDNJ-së, Koottummel kundër Austrisë, kërkesa nr. 49616/06, Aktgjykim i 10 dhjetorit 2009, paragrafët 19 dhe 20).

94. Për sa i përket çështjes së detyrimit për të mbajtur një seancë dëgjimore në gjykatat e shkallës së dytë ose të tretë, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së thekson se mungesa e një seance dëgjimore mund të justifikohet bazuar në karakteristikat e veçanta të rastit përkatës, me kusht që një seancë dëgjimore të jetë mbajtur në shkallë të parë (shih, rastin e Gjykatës KI85/19, parashtrues *Bujar Shabani*, Aktvendim për papranueshmëri, i 6 prillit 2020, paragrafi 83; si dhe shih në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së, Salomonsson kundër Suedisë, kërkesa nr. 38978/97, Aktgjykim i 12 nëntorit 2002, paragrafi 36). Prandaj, procedurat para gjykatave të apelit, dhe të cilat përfshijnë vetëm çështje të ligjit, dhe jo çështje fakti, mund të konsiderohen të jenë në përputhje me garancitë e mishëruara në nenin 6 të KEDNJ-së, edhe nëse në shkallë të dytë nuk është mbajtur një seancë dëgjimore (shih, rastin e GJEDNJ-së, Miller kundër Suedisë, kërkesa nr. 55853/00, Aktgjykim i 8 shkurtit 2005, paragrafi 30; dhe shih, gjithashtu, Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 30 prillit 2020 për nenin 6 të KEDNJ-së, E drejta për një proces të drejtë, pjesa civile, IV. Kriteret Procedurale; B. Dëgjimi Publik, paragrafin 383 dhe referencat e përdorura aty). Thënë këtë, dhe në parim, mungesa e një seance dëgjimore mund të justifikohet vetëm përmes “ekzistencës së rrethanave të jashtëzakonshme”, siç janë definuar përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në të kundërtën një e tillë është e garantuar për palët në të paktën njërin nivel të juridiksionit, bazuar në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së (shih, rastet e Gjykatës në rastin e ish-ndërmarrjes “Agimi”, KI145/19, KI145/19, KI146/19, KI147/19, KI149/19, KI150/19, KI151/19, KI152/19, KI153/19, KI154/19, KI155/19, KI156/19, KI157/19 dhe KI159/19, parashtrues *Et-hem Bokshi* dhe të tjerët, të cituar më lart; shih gjithashtu Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 30 prillit 2020 për nenin 6 të KEDNJ-së, E drejta për një proces të drejtë, pjesa civile, IV. Kriteret Procedurale; B. Dëgjimi Publik, paragrafin 386 dhe referencat e përdorura aty).

95. Përfundimisht, një seancë dëgjimore mund të mos kërkohet kur nuk ka çështje të besueshmërisë ose fakteve të kontestuara që kërkojnë një seancë dëgjimore dhe gjykatat mund të vendosin çështjen në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme në bazë të parashtrësive të palëve dhe materialeve të tjera të shkruara (shih, rastet e GJEDNJ-së: Döry kundër Suedisë, Aktgjykim i 12 nëntorit 2002, paragrafi 37; Saccoccia kundër Austrisë, Aktgjykim i 18 dhjetorit 2008, paragrafi 73).

(ii) *Aplikimi i parimeve të shtjelluara më lart në rrethanat e rastit konkret*

96. Gjykata fillimisht rikujton që bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, neni 6 i KEDNJ-së, në parim, garanton mbajtjen e një seance dëgjimore në të paktën njërin

nivel të vendimmarrjes. Një e tillë është, në parim, (i) e detyrueshme nëse gjykata e shkallës së parë ka kompetencën e vetme të vendimmarrjes përkitazi me çështjet e faktit dhe të ligjit; (ii) jo e detyrueshme në shkallë të dytë nëse një seancë dëgjimore është mbajtur në shkallë të parë, përkundër faktit që një përcaktim i tillë varet nga karakteristikat e rastit përkatës, për shembull, nëse shkalla e dytë vendos edhe për çështje fakti edhe ligji; dhe (iii) e detyrueshme në shkallë të dytë nëse një e tillë nuk është mbajtur në shkallë të parë, në rastet kur shkalla e dytë ka kompetencë të plotë për të vlerësuar vendimin e shkallës së parë, edhe përkitazi me çështjet e faktit dhe të ligjit. Përfundim nga këto raste, në parim, bëhen vetëm nëse “*ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore*”, dhe të cilat GJEDNJ, siç është sqaruar më lart, përmes praktikës së saj gjyqësore i ka përcaktuar si raste që kanë të bëjnë ekskluzivisht me çështje ligjore ose janë të natyrës së lartë teknike.

97. Gjykata edhe një herë rikujton që përmes praktikës së saj gjyqësore kishte konfirmuar se palët kanë të drejtë në seancë dëgjimore në të paktën njërën instancë (shih, në këtë kontekst rastin, [KI85/19](#), parashtruesi *Bujar Shabani*, cituar më lart, paragrafi 83). Kjo instancë, është kryesisht instanca e parë, dhe ajo e cila e ka juridiksionin për të vendosur edhe për çështje fakti edhe për çështje ligji. Në këtë kontekst, përkitazi me detyrimin për të mbajtur një seancë dëgjimore në gjykatat e shkallës së dytë ose të tretë, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së thekson se mungesa e një seance dëgjimore mund të justifikohet bazuar në karakteristikat e veçanta të rastit përkatës, me kusht që një seancë dëgjimore të jetë mbajtur në shkallë të parë. Në parim, nëse një seancë dëgjimore është mbajtur në shkallën e parë, procedurat para gjykatave të apelit, dhe të cilat përfshijnë vetëm çështje të ligjit, dhe jo çështje fakti, mund të konsiderohen të jenë në përputhje me garancitë e mishëruara në nenin 6 të KEDNJ-së, edhe nëse në shkallë të dytë nuk është mbajtur një seancë dëgjimore. Thënë këtë, përfundim nga e drejta për një seancë dëgjimore, janë vetëm ato raste, në të cilat përcaktohet se “*ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore*”. Këto rrethana, siç është sqaruar më lart, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së i ka klasifikuar si raste të cilat ndërlidhen me “*çështje ekskluzivisht ligjore apo të natyrës së lartë teknike*”.

(i) Nëse në rrethanat e rastit konkret ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme të cilat do të justifikonin mungesën e seancës dëgjimore

98. Gjykata edhe një herë rikujton që bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, palët kanë të drejtë në seancë dëgjimore në të paktën njërën instancë. Kjo instancë është kryesisht instanca e parë dhe ajo e cila e ka juridiksionin për të vendosur edhe për çështje fakti edhe për çështje ligji (shih, rastin e Gjykatës [KI85/19](#), parashtruesi *Bujar Shabani*, cituar më lart, paragrafi 83; dhe në rastet e ish-ndërmarrjes “Agimi”, [KI145/19](#), [KI145/19](#), [KI146/19](#), [KI147/19](#), [KI149/19](#), [KI150/19](#), [KI151/19](#), [KI152/19](#), [KI153/19](#), [KI154/19](#), [KI155/19](#), [KI156/19](#), [KI157/19](#) dhe [KI159/19](#), parashtrues *Et-hem Bokshi dhe të tjerët*, të cituar më lart, paragrafi 48; si dhe rastin [KI160/20](#), parashtrues *Komuna e Gjilanit*, cituar më lart, paragrafi 95). Në këtë kontekst, përkitazi me detyrimin për të mbajtur një seancë dëgjimore në gjykatat e shkallës së dytë ose të tretë, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së thekson se mungesa e një seance dëgjimore mund të justifikohet bazuar në karakteristikat e veçanta të rastit përkatës, me kusht që një seancë dëgjimore të jetë mbajtur në shkallë të parë. Në parim, nëse një seancë dëgjimore është mbajtur në shkallën e parë, procedurat para gjykatave të apelit, dhe të cilat përfshijnë vetëm çështje të ligjit, dhe jo çështje fakti, mund të konsiderohen të jenë në përputhje me garancitë e mishëruara në nenin 6 të KEDNJ-së, edhe nëse në shkallë të dytë nuk është mbajtur një seancë dëgjimore. Thënë këtë, përfundim nga e drejta për një seancë dëgjimore, janë vetëm ato raste, në të cilat përcaktohet se “*ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore*”. Këto rrethana, siç është sqaruar më lart, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së i ka

klasifikuar si raste të cilat ndërlidhen me “*çështje ekskluzivisht ligjore apo të natyrës së lartë teknike*”.

99. Për shembull, çështjet që ndërlidhen me sigurime sociale, GJEDNJ, kryesisht i ka klasifikuar si çështje të natyrës teknike, në të cilat jo detyrimisht është e domosdoshme një seancë dëgjimore. Sigurisht, nga ky rregull ka përjashtime. Në çdo rast, shqyrtohen rrethanat konkrete të një rasti. Për shembull, GJEDNJ nuk kishte konstatuar shkelje në rastet *Schuler-Zraggen kundër Zvicrës* dhe *Dory kundër Suedisë*, por kishte konstatuar shkelje në rastin *Miller kundër Suedisë* dhe *Salomonsson kundër Zvicrës*, edhe pse të gjitha ndërlidheshin me çështje të sigurimeve sociale.
100. Në mënyrë të ngjashme, GJEDNJ-ja vepron edhe në ato raste në të cilat çështjet para Gjykatës përkatëse janë ekskluzivisht ligjore, dhe nuk përfshijnë vlerësimin e fakteve kontestuese. Për shembull, në rastin *Saccoccia kundër Austrisë* (Aktgjykim i 18 dhjetorit 2008), GJEDNJ nuk konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së për shkak të mungesës së një seance dëgjimore, pasi konstatoi se çështjet për të cilat ankohej parashtruesi përkatës nuk ngërthenin çështje fakti, por vetëm çështje të limituar të natyrës ligjore (*Saccoccia kundër Austrisë*, cituar më lart, paragrafi 78), ndërsa në rastin *Allan Jacobsson kundër Suedisë* (nr. 2) (Aktgjykim i 19 shkurtit 1998), gjithashtu GJEDNJ nuk konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së për shkak të mungesës së një seance dëgjimore, pasi konstatoi se çështjet për të cilat ankohej parashtruesi përkatës nuk ngërthenin as çështje ligji e as fakti (shih, rastin e GJEDNJ-së, *Allan Jacobsson kundër Suedisë* (no. 2), cituar më lart, paragrafi 49).
101. Përkundrazi në raste të tjera e në të cilat, GJEDNJ-ja përcakton se çështjet para gjykatave përkatëse ngërthenin edhe çështje fakti edhe ligji, ajo nuk konstatoi se ekzistonin rrethana të jashtëzakonshme që do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore. Për shembull, në rastet *Malhous kundër Republikës Çeke*, (kërkesa nr. 33071/96, Aktgjykim i 12 korrikut 2001), GJEDNJ konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së për shkak të mungesës së një seance dëgjimore, pasi përcaktoi se çështjet për të cilat ankohej parashtruesi përkatës nuk ngërthenin vetëm çështje ligji por edhe fakti, përkatësisht vlerësimin nëse autoriteti më i ulët i kishte vlerësuar faktet në mënyrë të drejtë (shih rastin e GJEDNJ-së *Malhous kundër Republikës Çeke*, cituar më lart, paragrafi 60). Në të njëjtën mënyrë, në rastin *Koottummel kundër Austrisë* (Aktgjykim i 10 dhjetorit 2009), GJEDNJ konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së për mungesë të një seance dëgjimore, sepse konstatoi se çështjet para saj nuk mund të kualifikoheshin si çështje të natyrës ekskluzivisht ligjore ose të natyrës teknike, që do të mund të konsistonin në rrethana të jashtëzakonshme të cilat do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore (shih rastin e GJEDNJ-së, *Koottummel kundër Austrisë*, cituar më lart, paragrafët 20 dhe 21).
102. Në mbështetje të këtij konstatimi, Gjykata rikujton që përmes Aktgjykimit të GJEDNJ-së, *Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë*, specifikisht ishte përcaktuar se një seancë dëgjimore është e domosdoshme në rrethana që ngërthejnë nevojën për shqyrtimin e çështjeve të ligjit dhe të faktit, përfshirë rastet në të cilat është i nevojshëm vlerësimi nëse autoritetet më të ulëta kanë vlerësuar faktet në mënyrë të saktë. Kjo vlen posaçërisht në rrethana në të cilat, një seancë dëgjimore nuk është mbajtur as para shkallës më të ulët.
103. Në fakt, në disa raste GJEDNJ kishte konstatuar shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së kur një seancë dëgjimore nuk ishte mbajtur në një gjykatë me juridiksion apeli, edhe atëherë kur një seancë dëgjimore ishte mbajtur në instancën më të ulët, përkundër faktit se vlerësimi i domosdoshmërisë së seancës dëgjimore në nivel apeli është më pak rigoroz atëherë kur një seancë dëgjimore është mbajtur në shkallën e parë. Për shembull, në Aktgjykimin *Helmerts kundër Suedisë*, GJEDNJ shqyrtoi një rast në të cilin

parashtruesit përkatës i ishte mundësuar një seancë dëgjimore në shkallën e parë, por jo në nivelin e apelit, e cila kishte kompetencë të vlerësonte edhe ligjin edhe faktet në rrethanat e rastit përkatës. Në këtë rast, GJEDNJ kishte ritheksuar se **(i)** garancitë e mishëruara në nenin 6 të KEDNJ-së, jo detyrimisht garantojnë një seancë dëgjimore në nivel apeli, nëse një e tillë është mbajtur në shkallën e parë; dhe **(ii)** në marrjen e këtij vendimi, gjykata përkatëse duhet gjithashtu të ketë parasysh nevojën për trajtimin ekspeditiv të rasteve si dhe të drejtën për gjykim brenda një kohe të arsyeshme. Megjithatë, duke vënë theks në faktin se një përcaktim i tillë varet nga natyra e çështjeve që ngërthen një rast dhe nevojë për ekzistimin e rrethanave të jashtëzakonshme në mënyrë që të justifikohet mungesa e një seance dëgjimore, GJEDNJ konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së (për arsyetimin përkatës të rastit, shih paragrafët 31 deri 39 të rastit *Helmerts kundër Suedisë*).

104. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata fillimisht rikujton që Gjykata e Apelit ka juridiksion edhe për çështje fakti edhe për çështje ligji. Bazuar në paragrafin 4 të nenit 81, pika H (Procedura para Gjykatës së Apelit) të Ligjit nr. 04/l-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr. 03/l-222, në lidhje me nenin 190 dhe 197 të Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore i plotësuar dhe ndryshuar përmes Ligjit nr. 04/L-118, palët, ndër të tjera, kanë mundësinë që të ngritin ankesa para Gjykatës së Apelit edhe përkitazi me çështjet e ligjit dhe të fakteve, duke përfshirë edhe mundësinë që të paraqiten prova të reja.
105. Gjykata vëren se parashtruesi, kërkesën e tij për mbajtjen e seancës shqyrtuese në nivel të Gjykatës së Apelit e kishte mbështetur në nenin 81, pika G [Seanca e shqyrtimit] të Ligjit nr. 04/l-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr. 03/l-222 me arsyetimin për vërtetim të drejtë të gjendjes faktike në rastin e tij. Më saktësisht, parashtruesi i kërkesës përmes parashtrësës së tij drejtuar Gjykatës së Apelit, kishte kërkuar mbajtjen e seancës dëgjimore, duke theksuar specifikisht “[...] kërkoj nga Gjykata e Apelit që për shqyrtimin e kësaj ankesë të caktoj seancë publike, në të cilën do të elaborojmë shkeljet ligjore dhe gabimet në konstatimin e gjendjes faktike, siç i kemi theksuar edhe në ankesë, mirëpo elaborimi i tyre është i nevojshëm, ashtu që të vërtetohet drejtë gjendja faktike e kësaj çështje të konfliktit administrativ”.
106. Gjykata vëren se Gjykata e Apelit e kishte refuzuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës për mbajtjen e seancës shqyrtuese me arsyetimin se “[...] gjendja e vërtetuar faktike nga gjykata e shkallës së parë, nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore, kjo për faktin se aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkeljet esenciale të dispozitave procedurale dhe vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike ...”.
107. Gjykata edhe një herë rikujton që bazuar në praktikën gjyqësore të saj dhe të GJEDNJ-së, palët kanë të drejtë në seancë dëgjimore në të paktën njërën instancë. Kjo instancë, është kryesisht instanca e parë, dhe ajo e cila e ka juridiksionin për të vendosur edhe për çështje fakti edhe për çështje ligji.
108. Gjykata fillimisht vëren se Gjykata Themelore, duke iu referuar nenit 81G [Seanca e shqyrtimit] të Ligjit nr. 04/l-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat gjatë shqyrtimit të rastit të parashtruesit të kërkesës kishte theksuar si në vijim:

“Më qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës;03.02.2021, ka administruar provat relevante dhe atë: përgjigjja në padi e dt.16.10.2020 nga Dogana e Kosovës, Aktvendimin nr.01.3.2.2/470/16 i dt.2309.2019 i Doganës së

Kosovës, fatura nr.48383, të dt.20.05.2016, transferi bankar i dt.23.05.2016, packing lista CMR, deklarata eksportuese, Kontrata e shitblerjes së mallrave, Deklarata Doganore, Aktgjykim i A.nr.1235/16, i dt. 13.06.2019 i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Kërkesa për rishqyrtimin e vendimit nr. Prot. 470/07.06.2016, Procesi mbi përcaktimin e vlerës së mallrave, ankesa e paditësit DUD-at referuese, Provë nga dosja e Doganës”.

“Gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 81G të Ligjit nr.04/L-102, në seancën e mbajtur me datë 03.02.2021, vlerësoi ligjshmërinë e aktvendimit kontestues, thëniet në ankesë-padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, deklarimeve në seancë, konstatoi se kërkesëpadija e paditësit është e pabazuar”.

109. Gjykata vëren se seanca shqyrtuese ishte zhvilluar në Gjykatën Themelore ku ishin shqyrtuar provat, faktet dhe pretendimet e deklarimet e palëve në procedurë, mbi bazën e të cilave ishte shqyrtuar në hollësi rasti i parashtruesit të kërkesës dhe ishte konstatuar gjendja faktike.
110. Gjykata thekson se e drejta e parashtruesit të kërkesës, që çështja e tij të dëgjohej publikisht në kuptimin e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6. 1 të KEDNJ-së, në esencë nënkupton të drejtën për mbajtjen e një seance para të paktën një gjykate (shih, rastet e GJEDNJ-së Fischer kundër Austrisë, kërkesa nr. 16922/90, Aktgjykim i 26 prillit 1995 dhe rastin Salomonsson kundër Suedisë, kërkesa nr. 38978/97, Aktgjykim).
111. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata vëren se Gjykata Themelore përmes seancës shqyrtuese kishte shqyrtuar të gjitha faktet e paraqitura përmes ankesës dhe të përgjigjeve përkatëse në ankesë të parashtruesit të kërkesës dhe në fund kishte vlerësuar se nga provat e administruara “nuk ka mundur të vërtetoj një gjendje tjetër faktike”, duke refuzuar kështu ankesën e parashtruesit të kërkesës, gjersa, Gjykata e Apelit vetëm kishte aprovuar/konfirmuar të njëjtin konstatim të Gjykatës Themelore, duke theksuar se “gjendja e vërtetuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore”.
112. Në kontekst të pretendimit për mbajtje të seancës shqyrtuese në shkallën e dytë, Gjykata vëren se paragrafi 5 i nenit 38 të Ligjit nr. 03/l-202 për Konfliktet Administrative, i përcakton si në vijim: “Gjykata mund të vendosë çështjen pa shqyrtim verbal, nëse ka fakte të mjaftueshme dhe kur palët kanë dhënë pëlqimin e tyre në formë të shkruar”.
113. Në këtë aspekt, Gjykata do t’ i referohet edhe nenit 190.2 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, i cili përcakton si në vijim:

“Gjykata e shkallës së dytë duhet ta caktoj shqyrtimin e çështjes kur vlerëson se për konstatimin e gjendjes faktike, saktësisht dhe plotësisht, duhet vërtetuar fakte të reja dhe marrë prova të reja nën kushtet e nenit 180, paragrafët 1 dhe 2 të këtij ligji”.
114. Në këtë drejtim, Gjykata gjithashtu i referohet edhe nenit 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, i cili thekson:

“399.1 Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigjja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadija.

399.2 Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërthënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia qartazi janë në kundërthënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura".

115. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata nuk mund të mos vërej se parashtruesi i kërkesës përveç që kishte dorëzuar në Gjykatën e Apelit ankesën me pretendimet dhe elaborimet e tij për konstatim të gabuar të gjendjes faktike, shkeljeve të dispozitave procedurale dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale, parashtrësia e tij e 25 majit 2021, drejtuar Gjykatës së Apelit ngërthente në vete vetëm kërkesën e tij për mbajtjen e seancës shqyrtuese në Gjykatën e Apelit mbi arsyetimin e vetëm që të *"elaborojmë shkeljet ligjore dhe gabimet në konstatimin e gjendjes faktike, siç i kemi theksuar edhe në ankesë [...]"*, dhe jo për paraqitjen apo nevojën për shqyrtimin e ndonjë prove apo rrethane të re në rastin e tij.
116. Në rastin konkret, Gjykata nënvizon se Gjykata e Apelit vendosjen e rastit pa mbajtur seancë dëgjimore e arsyetoi se *"gjendja e vërtetuar faktike nga gjykata e shkallës së parë, nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore"*.
117. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit në Aktgjykimin e saj nuk kishte hapur çështjen e gjendjes faktike në kuptim të vlerësimit të ndonjë prove të re, por vetëm i kishte konfirmuar përfundimet e nxjerra lidhur me gjendjen faktike nga ana e Gjykatës Themelore si dhe kishte analizuar aplikueshmërinë e ligjit nga ana e Gjykatës Themelore nën dritën e konstatimeve të gjendjes faktike nga vet kjo e fundit.
118. Kështu, duke pasur parasysh konsideratat e mësipërme, Gjykata nuk vëren se parashtrësia e parashtruesit për mbajtjen e seancës shqyrtuese në Gjykatën e Apelit ishte në gjendje të ngrinin ndonjë çështje faktike ose juridike në lidhje me të drejtat e tij, të cilat ishin të një natyre të tillë, për të kërkuar një seancë shqyrtuese për zgjidhjen e tyre, përveç atyre që i kishte dorëzuar përmes ankesës me shkrim (shih, paragrafin 120).
119. Gjithashtu, Gjykata, në kontekst të pretendimit për mbajtje të seancës shqyrtuese, thekson se përderisa dëgjimi publik përbën një parim themelor të parashikuar në nenin 6, paragrafi 1 të KEDNJ-së, detyrimi për të mbajtur një seancë të tillë nuk është absolut (rasti i GJEDNJ-së: [De Tommaso kundër Italisë, kërkesa nr. 43395/09](#), Aktgjykim i 23 shkurtit 2017, paragrafi 163). Për të vërtetuar nëse një gjykim përputhet me kërkesën e publicitetit, është e nevojshme të merren parasysh procedurat në tërësi ([Axen kundër Gjermanisë, kërkesa nr. 8273/78](#), Aktgjykim i 8 dhjetorit 1983, paragrafi 28).
120. Në këtë kontekst, Gjykata do t' i referohet edhe nenit 7 [Parimi i efikasitetit] të Ligjit nr. 03/l-202 për Konfliktet Administrative, i cili përcakton si në vijim:

"Gjykata e zbaton konfliktin administrativ shpejtë dhe pa zvarritje, duke iu shmangur veprimeve dhe shpenzimeve të panevojshme, me çka e pamundëson keqpërdorimin dhe zvarritjen e realizimit të të drejtave të palëve, të pjesëmarrësve të tjerë në konflikt dhe vendimin e nxjerrë në afat të parashikuar".
121. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se duke u bazuar në praktikën e GJEDNJ-së, gjykatat e rregullta duhen të kenë parasysh kërkesat/nevojën për efikasitet dhe parimin ekonomik. Mbajtja sistematike e seancave mund të jetë pengesë për kujdesin e veçantë që kërkohet gjatë administrimit të rastit (shih, [mutatis mutandis](#) rastin e GJEDNJ-së, [Affaire Schuler-Zraggen kundër Zvicrës, kërkesa nr. 14518/89](#), Aktgjykim i 24 qershorit 1993).

122. Në këtë aspekt, Gjykata dëshiron të theksojë se në një shoqëri demokratike sipas KEDNJ-së, e drejta për një administrim të drejtë të drejtësisë zë një vend aq të rëndësishëm saqë një interpretim i përpiktë/restriktiv i dispozitave nuk do t'i përgjigjej qëllimit dhe objektivit të garancive të nenit 6 të KEDNJ-së (shih, *mutatis mutandis* rastet e GJEDNJ-se: [Ryakib Biryukov kundër Ruisë, kërkesa nr. 14810/02](#), Aktgjykim i 17 janarit 2018, paragrafi 37; [Delcourt kundër Belgjikës, kërkesa nr. 2689/65](#), Aktgjykim i 17 janarit 1970, paragrafi 25; [Wemhoff kundër Gjermanisë, kërkesa nr. 2122/64](#), Aktgjykim i 27 qershorit 1968, paragrafi 8).
123. Prandaj dhe në përfundim, Gjykata duke marrë parasysh faktin se **(i)** në rastin e parashtruesit të kërkesës ishte zhvilluar një seancë shqyrtuese në një nivel juridiksioni, respektivisht në shkallë të parë nga Gjykata Themelore; **(ii)** parashtruesi i kërkesës kishte mundësi të dëgjohet para Gjykatës Themelore me kompetencë për vlerësimin e fakteve dhe të ligjit; **(ii)** Gjykata e Apelit kishte dhënë arsyetimin për mosmbajtjen e seancës shqyrtuese në nivel të shkallës së dytë; **(iii)** parashtruesit të kërkesës i ishte dhënë mundësi të bollshme për të paraqitur çështjen e tij me shkrim para Gjykatës së Apelit; **(v)** Gjykata e Apelit gjatë shqyrtimit të rastit nuk kishte hapur çështjen e gjendjes faktike në kuptim të vlerësimit të ndonjë prove të re; **(v)** si dhe çështje në shqyrtim para Gjykatës së Apelit ishte ekskluzivisht ligjore dhe e natyrës teknike, konstaton se vendosja e rastit nga ana e Gjykatës së Apelit vetëm mbi bazën e dosjes së lëndës e cila në vete përmbante çështje ekskluzivisht ligjore apo të natyrës së lartë teknike, është në përputhje me parimet e përcaktuara në praktikën e GJEDNJ-së, e cila ka zbatim të drejtpërdrejt në juridiksionin e Kosovës.
124. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se parashtruesi nuk e ka mbështetur pretendimin lidhur me shkeljen e të drejtës për seancë dëgjimore. Andaj, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës, për shkelje të së drejtës për mbajtjen e seancës dëgjimore, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të KEDNJ-së, janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese siç është përcaktuar në paragrafin 2 të rregullit 39 të Rregullores së punës.

III. Pretendimi për vlerësim të gabuar të provave gjatë shqyrtimit të rastit

125. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon konstatim të gabuar të gjendjes faktike në rastin e tij, me arsyetimin se gjykatat e rregullta kanë vlerësuar gabimisht provat e paraqitura lidhur me çmimin e transaksionit të mallit të importuar nga parashtruesi.
126. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës thekson se me anë të Deklaratës Unike Doganore (DUD), në Zyrën e Brendshme Doganore në Prishtinë, ka deklaruar për doganim në cilësinë e importuesit "*makina fotokopjuese të ndryshme të përdorura në gjithsej 3 emërtime, më detajisht sipas faturës dhe deklaratës doganore. (...) Me rastin e deklarimit për doganim të këtij malli importuesi ka poseduar dhe prezantuar para zyrtarëve doganorë të gjitha dokumentet obligative për deklarimin e mallit dhe të tjera të nevojshme për ta bërë bindëse vlerën e transaksionit dhe vlerën reale të mallit, përkatësisht: DUD kontestues, fatura e mallit, në të cilin është evidentuar numri dhe data e faturës, malli, sasia për njësi dhe sasia totale, çmimi për njësi dhe shuma e përgjithshme, Urdhërpagesa bankare në emër të kësaj fature e dt. 23.05.2016, në të cilën është evidentuar numri i faturës së paguar, është përshkruar i tërë malli i paguar dhe vlera e paguar në përputhje me faturën, Deklarata eksportuese nga autoritetet doganore gjermane, në të cilën është evidentuar numri i faturës lëndore (48383), si dhe kontrata e shitblerjes së mallrave e dt. 02.05.2016, në të cilën është theksuar se kemi të bëjmë me mallra të përdorura, nga stoku për të cilat shitësi nuk garanton funksionalitetin, çka vërteton çmimin e lirë të tyre".*

127. Në këtë kontekst, parashtruesi i kërkesës thekson se dokumentet e lartpërmendura nuk janë marrë parasysh nga zyrtarët doganorë të cilët kanë kontestuar vlerën e këtij malli dhe e kanë rivlerësuar atë, ndonëse nuk kanë poseduar asnjë provë konkrete materiale që do të dëshmonte se parashtruesi i kërkesës nuk ka paguar vlerën transaksionale të mallit.
128. Në lidhje me këtë pretendim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës thekson se *“transaksioni bankar i datës 23 maj 2016, me vlerë prej 5,496.00 euro është lexuar si në mospërputhje me faturën nr.48383, me arsyetimin se nuk përshkruan tërë mallin por vetëm një pjesë të tij dhe kjo nuk paraqet vlerësim të gabuar të provës dhe të gjendjes faktike, por paafhtësi të gjyqtarit për të parë përmbajtjen e saktë të këtij dokumenti, prandaj konsiderojmë se konsiston në proces të parregullt gjyqësor, sepse siç mund të shihet në transfer bankar janë përshkruar tri pozicionet e mallrave si në faturë, është theksuar sasia e tyre dhe vlera e përgjithshme e transferit në përputhje me faturën”*.
129. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës kryesisht konteston mënyrën e të vërtetuarit të gjendjes faktike nga ana e gjykatave të rregullta. Në këtë aspekt, Gjykata thekson se në bazë të shkresave të lëndës, vërehet se gjykatat e rregullta në procedurën e provave të shqyrtimit kanë administruar provat relevante dhe atë: *“përgjigjja në padi e dt.16.10.2020 nga Dogana e Kosovës, Aktvendimi nr.01.3.2.2/470116 i dt.23.09.2019 i Doganës së Kosovës, fatura nr.48383, dt.20.05.2016, transferi bankar i dt.23.05.2016, packing lista, CMR, deklarata eksportuese, Kontrata e shitblerjes së mallrave, Deklarata Doganore, Aktgjykimi A.nr.l235/16, i dt.13.06.2019 i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Kërkesa për rishqyrtimin e vendimit nr.prot.470107.06.2016”*.
130. Gjykata vëren se dokumentacioni i dorëzuar nga parashtruesi i kërkesës nuk dëshmonte mjaftueshëm se vlera e paguar përfshinte pagesën për të gjithë mallin e prezantuar për doganim dhe në mungesë të provave lidhur me pagesën e mallit të prezantuar, gjykatat e rregullta në mënyrë të drejtë ishin referuar dhe kishin aplikuar nenin 33 dhe 35 të Kodit Doganor.
131. Gjykata konsideron se pretendimi për mënyrën e të vërtetuarit të gjendjes faktike përbën çështje të faktit dhe të ligjit, çka është detyrë dhe prerogativë e gjykatave të rregullta. Gjykata, bazuar në parimin e subsidiaritetit nuk mund t'i zëvendësojë vendimet e veta me ato të gjykatave të rregullta.
132. Në lidhje me këtë, Gjykata, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por duke marrë parasysh edhe karakteristikat e saj, siç përcaktohen në KEDNJ, si dhe parimin e subsidiaritetit dhe doktrinën e shkallës së katërt, vazhdimisht ka theksuar ndryshimin midis *“kushtetutshmërisë”* dhe *“ligjshmërisë”* dhe theksoi se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e fakteve ose interpretimin e gabuar dhe zbatimin e gabuar të ligjit, që pretendohet të jenë bërë nga një gjykatë e rregullt, përveç dhe për aq sa gabimet e tilla kanë mundur të shkelin të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë dhe/ose KEDNJ (shih, rastet e Gjykatës [KI128/18](#), parashtrues: *Limak Kosovo International Airport J.S.C., “Adem Jashari”*, Aktvendim për papranueshmëri, i 28 qershorit 2019, paragrafi 55; [KI62/19](#), parashtrues: *Gani Gashi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 19 dhjetorit 2019, paragrafët 56-57; [KI110/19](#), parashtrues: *Fisnik Baftijari*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 nëntorit 2019, paragrafi 40).
133. Gjykata gjithashtu vazhdimisht ka theksuar se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë gjetjet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e së drejtës materiale dhe se nuk mund të vlerësojë vetë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të

miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “*shkallës së katërt*”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj (shih, rastin e GJEDNJ-së: [García Ruiz kundër Spanjës](#), Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe referencat e përdorura atje; dhe shih gjithashtu rastet e Gjykatës: [KI128/18](#), të cituar më lart, paragrafi 56; dhe [KI62/19](#), të cituar më lart, paragrafi 58).

134. Gjykata, duke i marrë parasysh të gjitha shtjellimet e sipërtheksuara, në rrethanat e rastit konkret, konsideron se parashtruesi i kërkesës thjeshtë është i pakënaqur me rezultatin e procedurës pranë gjykatave të rregullta. Megjithatë, pakënaqësia e tij nuk mund vetvetiu të ngrejë një pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë (shih, rastin e GJEDNJ-së [Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë](#), Aktgjykim i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).
135. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për konstatim të gabuar të gjendjes faktike janë pretendime që i takojnë kategorisë së “*shkallës së katërt*” dhe si të tilla, këto pretendime të parashtruesit të kërkesës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

Përfundim

136. Në fund, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës është e papranueshme, sepse (I) pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së përkitazi me pretendimet e parashtruesit të kërkesës për vendim të paarsyetuar gjyqësor, janë pretendime që kualifikohen si pretendime “*të pambështetura apo të paarsyetuara*”; dhe si të tilla këto pretendime të parashtruesit të kërkesës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese; (II) pretendimet për mos mbajtje të seancës dëgjimore refuzohen si qartazi të pabazuara në baza kushtetuese; (III) përkitazi me pretendimet e parashtruesit të kërkesës për konstatimit të gabuar të gjendjes faktike refuzohen si pretendime të “*shkallës së katërt*”. Prandaj, kërkesa në tërësi deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenet 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, në nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe në rregullat 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 4 prill 2023, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Bajram Ljatifi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Gresa Caka-Nimani